

George Fred Williams

SH Q I P T A R Ë T

Përkthyer nga anglishtja prej Shaban Ballës

**Drejtësia dhe e vërteta nuk janë mbrojtje ose
arësye në sallat e diplomacisë
Djali jem, ti nuk e di se me sa pak mëshirë
qeveriset bota**

Tiranë - Shtypshkronja “Dielli” - 1934

Parathënie e botimit të parë

E gjeta të vlefshme përkthimin e këtyre rreshtave mbasi këto përmbajnë gjykimin e një të huaji mbi Shqipërinë, i cili e formoi këtë vetgjykim duke qenë vetë në kontakt me Shqiptarët e duke shikuar me sytë e vet çdo gjë që ka shkruar. Përveç kësaj, ky shkrimtar është i një shteti të cilit nuk i intersonte ose i interesonte shumë pak gjendja politike e Shqipërisë e për këtë çdo fjalë që shkruan ky njeri është e sigurtë se e shkruan siç ia ndien ndërgjegjeja e vet e jo pse ashtu ia lyp pozita diplomatike. Për shembull, në Kreun IV tek nënartikulli “Europa përkrah sundimin turk” do të shikoni se San Xhuljano, Ministër i Jashtëm i Italisë, nga pozita e tij diplomatike shkruan të kundërtën e asaj që ndjen në shpirtin e tij. Por që shkrimtari i jonë shkruan ashtu si e ndien, do ta vini re po të këndonni me kujdes Kreun III “Rënia e Qeverisë së Vidit”. Aty do të formoni një vetgjykim se sjelljet e tij në këtë mënyrë proshqiptare ndoshta u bënë shkak që ai të shtrëngohesh me dhënë dorëheqjen nga pozita e tij në Europë.

Xhorxh Fred Uilliams më 1914 ishte Ministri i Amerikës në Greqi dhe në Mal të Zi dhe vëzhgues i Komisionit Ndërkombëtar në Durrës, komision i cili do të udhëhiqte dhe do të bashkëpunonte me qeverinë e Vidit. Por zoti Uilliams duke e pa të pamundur bashkëpunimin në mes tyre dhe duke e

pa se punët po shkonin mbrapsht pse marrëveshja e Londrës e kishte mbjellë shumë ters farën, e ma tepër pse marrëveshja e Londrës caktonte një princ kurse Vidi erdhi me titullin mbret, mbas shumë mundimesh për marrëveshje sa me kryengritësit e Shqipërisë së mesme, sa me ata të Jugut, u bind se këto punë ishin të kota dhe vendosi të marrë një masë të fundit. Shkoi në Shqipërinë e Jugut ku pruri në marrëveshje “epirotët” kryengritës me vlonjatët që të bashkoheshin e të shpallnin pavarësinë e tyre, gjithmonë me qëllim që sapo të zhdukej qeveria e Vidit e cila doemos nuk kishte jetë të gjatë, t’i bashkonte kësaj pavarësie edhe pjesën e sipërme të Shqipërisë. Mirëpo, posa muarën vesh këtë gjë diplomatët e Europës me të shpejtë dërguan në Vlorë dy luftanije që përmbanin anëtarë të komisionit të Durrësit, të cilët nën hijen e topave të fuqive të mëdha të Europës e ndaluan këtë bashkim që ky zotni me shumë mund e bëri.

Atëhere zoti Uilliams u bind krejtësisht që veprat e fuqive të mëdha me marrëveshjen e Londrës nuk patën për qëllim ta bëjnë këtë shtet të lirë, por të gjejnë shkaqë se si me e shtypur ma tepër, e duke patur në dorë këtë dhe tjera fakte ky vendosi me e lënë këtë skenë mëkatesh, por njëherit me ngritur perden e me paraqitur komedinë tragjike dhe shpirtin e zi të diplomacisë Europiane. I dhanë rastin Shqipërisë në Mbledhjen e Londrës për ta provuar nëse Shqiptarët janë të zotët apo jo përsa paradëshirojnë. Por me mënyrën që ata i kishin hartuar planet e tyre mund t’i hidhnin hi syve të

gjithë botës duke e bërë me e quajtur të zezën të bardhë, e prandaj Shqipëria lëkundej atë kohë në djepin e fatit herë mbi dhe, herë jasht gropës së zezë të tmerrshme e të helmatisur. Gjindej ky djep pikërsisht mbi gropën e pafund, kur përfaqësuesit kryesorë të diplomacisë Europiane, të mbuluar me maska fytyrë-njeriu, kishin vu tehët e bajonetave të tyre mbi litarët që varesh ky djep për t'i pre e për ta lëshuar fatin e Shqipërisë në këtë gropë vdekjeje që të mos mund të ngrihesh kurrë.

Për të qenë korrekt ndaj pikpamjes njerëzore, këta zotërinj kishin filluar me përhapë fjalën se ua dhamë provën e lirisë Shqiptarëve por nuk po janë të zotët me e mbajtur dhe për fakt tregonin me gisht kryengritjet e brendshme, shkaktarët e të cilave ishin ata vetë. Pikërisht në këtë kohë të duhur e të rrezikshme për Shqipërinë, zoti Uilliams heq maskat që iu japin pamje njerëzore këtyre diplomatëve dhe nxjerr në shesh fytyrat e tyre të lyera me gjak të pafajshëm e ia tregon me gisht botës duke deklaruar se të fshehtat e kësaj diplomacie janë shkaku i kaq gjakderdhjeve dhe deklaroi pafajsinë dhe vujtjet e Shqiptarëve e mundimet e tyre për liri. Ai shpreh hapur se Shqiptarët nuk janë të egër e të rrezikshëm, siç e thonë diplomatët Europës, porse Shqiptarët janë fisnike, janë trima, janë të ndershëm, janë liridashes dhe kanë mikpritjen më të madhe në botë. Këto deklarata zoti Uilliams ia bëri më tepër popullit të vet Amerikan duke iu lutur që të ndërhyje sa më parë për t'i ndihmuar ketij populli

në të drejtat trashëgimore që kërkon dhe në varfërinë e tij, shkakun e së cilës ia ngarkon fuqive të mëdha të Europës.

Përkthyesi Shaban Balla

Tiranë, 20 Mars 1934

Parathënie e botimit të dytë

Kur m'u tregua ky libër i vockël e lexova menjëherë dhe pa vonesë, e rishtypa dhe e redaktova duke ruajtur përkthimin origjinal. Libri është shkruar para 90 vjetësh, përkthyer e botuar në Shqip para 70 vjetësh dhe ribotohet për herë të dytë tani. Falenderoj me këtë rast përkthyesin Shaban Balla që e kaloi në Shqip veprën e respektuar të Xhorxh Fred Uilliamsit dhe dajën tim Qazim Kuqashin që kishte ruajtur një botim të tillë 70 vjeçar.

Së pari botimi apo ribotimi i një libri të tillë është një gjë shumë e mirë, sepse shpreh respektin për një njeri shpirtmadh e shpirtdrejtë si Xhorxh Fred Uilliamsi, për edukimin e shkollimin e tij dhe respektin për vlerat që përcjell pena e tij. Nga ana tjetër, është për të ardhur keq që ajo histori e dhimshme e Shqipërisë e fillimit të Shekullit XX, në vend që të ishte për arshivë, vazhdon poshtërsisht të nëpërkëmbet edhe në kohën e tanishme. Libri pohon thënien popullore se të huajt, akoma më shumë armiqtë, kur gjejnë shesh bëjnë përshesh. Libri tregon sa tragjike kanë qenë (dhëmsurisht edhe janë) ndaj shqiptarëve përcarjet e shkaktuara nga armiqtë. I vetquajturi mbret Princ Vidi qëndroi

në Shqipëri në periudhën 7 Mars – 3 Shtator 1914. Siç edhe shkruan Xhorxh Fred Uilliamsi, nga ajo rrëmujë mizore e Luftës I Botërore shqiptarët vetëm e pësonin. Pena e Xhorxh Fred Uilliamsit përcjell rëndësinë e vlerave njerzore që duhet të kenë udhëheqësit që organizojnë, drejtojnë apo udhëheqin shtetet. Vetëm njerëzit me mirësjellje, me shpirtmadhësi, fisnikërisht të respektuar, të palodhur në punë, me vullnet dhe trimëri janë ato që kanë shkaktuar dhe udhëhequr përparimin e popujve.

Xhorxh Fred Uilliams (1852-1932) lindi në Dedham të Masaçusetsit. U arsimua në degën e ligjeve në Masaçusets më 1872 dhe pas studimeve të tjera u bë avokat. Gjatë viteve 1880-1887 kreu redaktime të botimeve të rëndësishme ligjore në vitet. Më 1889, ishte anëtar i legjislaturës së Masaçusetsit dhe gjatë viteve 1891-1993 ishte anëtar demokrat i Kongresit Amerikan. Gjate viteve 1913-1914 ishte Ambasador i SHBA në Greqi dhe Mal të Zi.
Saimir Lolja Tiranë, 19 Tetor 2004

SH Q I P T A R Ë T - T O K A D H E B A N O R Ë T

**Tokë e Shqipërisë lemë të hedh sytë e mij,
Mbi ty, O nanë e mjerë e njerëzve primitivë.
- Bajroni tek “Udhëtimi i Çajlld Heroldit”**

“Bah! Shikoni këto barbarë!” ka thirrur çdo tiran që ka shtyrë në fatkeqësi viktimën e vet, kur më në

fund e ka pa të pamundshme me e bërë skllav. Ngjarja e dhimshme e Shqipërisë nuk i është treguar popullit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ajo ka qenë zhdukur në vendin e vet të Bajronit dhe të shteteve të mëdha, të cilët kanë vendosur të zhdukin nga faqja e dheut këtë popull heroik. Në sallat e errta të diplomacisë Europiane për shekuj me radhë ka qenë mbyllur e munduar fati i Shqipërisë. Edhe tani, me lot ndër sy dhe krejt e dobësuar nga robëria dhe padrejtësia e shekujve, ajo po nxjerr përpara duart thatanike për të kërkuar drejtësi dhe liri; por akoma më kot. Po, shpërblimi i mëkateve është vdekja dhe kujdesi i drejtë i Perëndisë nxjerr përpara faktin se gjendja e keqe e sotme e Europës rrjedh drejtpërsëdrejti po nga ajo politikë që e përdori për Shqipërinë. Megjithëse ka shumë për të thënë, dal përpara ta them unë këtë ndodhi, të përshkruaj tokën, origjinën, gjuhën, zakonet dhe historinë e këtij populli, intrigat e Europës për ta mbajte këtë popull skllav të Turqisë, mundimet dhe kërkesat e drejta të tij për liri dhe pavarësi, dhe më në fund se si Amerika mund ta ndihmojë duke i prirë këtij populli në të drejtat e veta.

Toka e Shqiptarëve

Valona ishte një pjesë e vogël e kësaj toke prej së cilës ata që shkelën Shqipërinë krijuan emrin Albania në shekullin XI. Emri i vërtetë i kësaj toke është Shqipëri dhe i popullit Shqiptar që domethënë toka dhe bijt e Shqipes. Shqipëria, në mes të Malit

të Zi dhe të Austrisë kah Veriu, le Serbinë kah Lindja dhe Greqinë kah Jugu, dhe shtrihet 390km përgjate bregut Lindor të Adriatikut. Ajo është shumë afër bregut Italian ku qytetet dhe portet prej Brindisi deri në Venedik duket sikur duan me thënë se janë kryenaltë me përparimin dhe lumturinë e tyre përpara anës tjetër të shkretë të detit të fqinjës së vet. Si në Jug ashtu edhe në Veri të Shqipërisë ka porte të bukur dhe liqenj të mëdhenj e të mrekullueshëm. Buza e Drinit dhe liqeni i Shkodrës, të cilët janë tani pothuaj të pavozitshëm, duhet që nëpërmjet tyre t'u zhvillonte një tregti e madhe e përgjithme. Katër porte të tjerë përgjatë bregut Shqiptar janë pa mole dhe pa farë përmirësimi. Lumenjt janë të mbushur e të pavozitshëm, ndërsa pyje të mëdhenj po kalben në balta e moçale. Fusha të mëdha e pjellore shërbejnë vetëm si një kullote e dobët për tufat e dhenve të një race shumë të dobët; i vetmi plug është parmenda e drunjtë e Romës së lashtë. Minierat e punuara prej Romakëve dhe Venecianëve janë zhdukur nga pamja dhe s'dihet fare ku janë. Përveç rrugës Egnatia, një tregues i pushtimit Romak, s'ka rrugë dhe fuqi të mëdha ujrash shkojnë kot, sepse s'ka asnjë central elektrik. Nuk ka bankë dhe ka shumë pak të holla; nuk ka një zyrë postare të vendit veç atyre të të huajve. Ka shumë pak gazeta dhe libra; shumë rrallë lëviz ndonjë lloj maqine dhe madje s'ka as qeveri të vendit.

Ministri i Punëve të Jashtme të Italisë, i shquari San Xhuljano, bëri një përshtkrim se si mbërriti nga

bregu i detit deri në Shkoder, qyteti kryesor, hypur mbi kalë, nëpër fusha, moçale, ferrishte e baltra, mbi një rrugë të verbët, ndërsa gjatë rrugës së tij në njërin krah kalonte i bukuri lumë pengues dhe i pavozitshem, i cili me pak shpenzime mund të bëhet që të kalojnë nëpër të prej qytetit deri në det vaporë prej më se tre mijë tonelatash. E pamundur! Në zemër të Europës të ndodhet një shkretirë kësi soji, por qe një fakt. Në të vërtetë kjo rrjedh nga se ky vend ka mundësira përparimi më të mëdha se çdo shtet tjetër i Ballkanit por që Europa e ka pa të arësyeshme me e bërë këtë vend të mjerë e të shkretë. Ky vend zë pozitën gjeografike më të mire në Europe; ai është çelsi i tregtisë së Ballkanit dhe porta e kalimit për në Lindje. Me gjithë këtë, sot nuk ka asnjë udhë hekuri që t'i përshkojë Ballkanet prej Adriatiku në atë mënyrë që kjo të jetë një vijim i linjës Austriake.

Faksimili i origjinalit të librit“Shqiptarët“

Kur Princ Vidi dhe përfaqësuesit e gjashtë fuqive të mëdha e bënë Durrësin kryeqytet të Mbretërisë, ata sot zunë një vend të keq, një katund të qelbët, porse Durrësin nën emrin Epidamus siç quhej në kohët e vjetra Ciceroni dy mije vjet përpara e përshkroi si një vend të bukur, të madh e të lulëzuar. Në atë kohë ishte një qendër e madhe tregtie, por sot sikurse edhe fqinji i tij Tivari në Veri, qëndrojnë si njëmendore e mëkatit të shkatërrimit turk. Në tokën e Epirit ku sot 600'000 frymë rrojnë mjerisht, nën Pax Romana rronin

4'000'000 në lumturi. Do të shohim më vonë se jo natyra por arti i zi e zbriti këtë vend nga lumturia e hershme në gjendjen e dhimshme e të mjeruar të sotme. Kjo u qeth e u shkurtua në traktatin e Berlinit, në ndarjen e Ballkanit dhe në marrëveshjen e Londrës, saqë askush s'mund të dije sot sipërfaqen dhe popullsinë e saj. Mund të jetë e madhe sa shtetet Konektikat dhe Masaçuset bashkë dhe popullata mund të çmohet nga 500'000 në 1'500'000, por mesatarisht mund të jetë 750'000 shpirt. Shkodra ka 40'000 banorë dhe me pak përjashtime ky vend përbëhet prej katundesh.

Origjina e Shqiptarëve

Mbrapa në kohët parahistorike, para se poetët e Homerit të këndonin për perënditë e tyre dhe heronjtë e përrallave, përpara se të shkruhej gjuha greke, rronte një popull i qujtur Pellazg. Herodoti (484-425 p.e.s.) iu vesh Pellazgëve historinë e cila këto i përmend shumë më parë se sa qytetërimin e grekërve; punimi i ashpër që mbulon anët e Panteonit në Athinë akoma quhet Pellazgjik. Këta ndërtnuan mure të mëdhenj që quhen ciklopikë dhe për të cilët Prof. Pokok thotë që qenë ndërtnuar shumë më përpara se të egzistonin grekërit e Homerit. Prej kësaj race të fortë parahistorike mbetën vetëm Shqiptarët. Vetëm në kohë të vona u shkoqit se Pellazgët qenë Ilirianët e vjetër, e para degë Indo-Europiane, perandoria e të cilëve shtrihesh që nga Azia e Vogël deri në Adriatik dhe nga Veriu deri në Danub. Nga studimet e

shkrimtarëve të rinj, si Prof. Maks Myller dhe Prof. Pot, në gjuhën Shqipe u bë e qëndrueshme kjo origjine. Këto Ilirianë, që rrojnë akoma në Shqipëri si Toskë, u shpërndanë edhe në Itali dhe njihen si Toskë, Toskanë, Etruskë.

Është e kotë të kërkohet për perënditë e Greqisë në etimologjinë e gjuhës së saj. Në gjuhën Shqipe këto janë shumë të qarta dhe domethëniet e tyre shumë të drejta. Për shembull, Kaos është hapsi, hapësira; Erebus, biri i Kaosit, është er-het-os, me e bërë të errët; Uranos është I-Vran-os, domethënë zana e reve, vranët; Zeus, Zaa, Zee, Zoot-Zot, zë rrufe; Athena është E thëna, me thënë fjalën; Nemesis, nemës, domethënë nam, thirrje e djallit; Muse, Mosis, është mësuesi; Afërdita domethënë afër ditës, agimi. Kur do të jetë studiuar mirë gjuha Shqipe dhe kur do të jenë zhvarrosur gojëdhanat e saj, atëhere shumë nga veprat e Homerit do të rishkohen dhe ca nga ato do të jetë nevoja edhe të korigjohen. Herodoti nuk e pati ditë që emrat e heronjve të veprës së Homerit ishin fare qartë në gjuhen Pellazgjike. E deri edhe emri i vet i Homerit mund të gjurmohet në gjuhën Shqipe: I mirë, dhe në formën Imiros do të thotë poezia e mirë.

Flamuri kombëtar

Në gjuhën Shqipe është Agamemnon, Ai-ge-mendon, ai që mendon; Ajaks, ai gjaksi, gjakderdhës; Priamos, Bir-i-amës, biri i amës e me kuptim ironik Biri i tokës, i vendit; Akili, i qiellit,

një i zbritur nga qielli; Odiseu, i udhës, udhëtari, aji që shëtiti; Ithaka, i thak, idhnak; Droilos, Droili(os), ai që druhet, frigac. Shumë të tjera mund t'i shtohen kësaj liste. Nuk është çudi në se njerëzit që kanë studiuar gjuhën Shqipe të thonë se kjo është gjuha origjinale e Homerit dhe që grekërit e morën nga poetët Pellazgjike të shumtën e këngëve të trimërive dhe ato heroike. Sa dituri e madhe e pret arkeologun kur toka Shqiptare do të hapi thesarin e historisë Pellazgjike! Këta dhe shumë rrjedhime të tjera provojnë që Shqiptarët sot janë mbi tokën e të parëve dhe flasin gjuhën e stërgjyshëve të tyre. Edhe përpara se dega helene të njifej në malet e Thesalisë, Shkodra, qyteti kryesor i Shqipërisë, që pa dyshim kryeqyteti i mbretërisë madhështore të Ilirisë. Shqipja që gjuha amtare e Aleksandrit të Madh që pushtoi botën dhe e Pirros së Epirit, një nga gjeneralët më të mëdhenj që përmend historia dhe përbalues i fundit i ushtrive pushtuese Romake. Një tragjedi, përtej përfytyrimit të tragjedistit, është kjo që një racë e vjetër dhe e fortë erdhi në një gjendje kaq të keqe dhe mizore, gjë e cila shikohet si skandal i qytetërimit Europian. Nuk është për çudi që otomanët nuk lejuan ndonjë germim në tokën Shqiptare, sepse ajo mund t'i sillte ndërmend këtij populli lulëzimin e parë.

Vendasit e Shqipërisë

Nuk janë turq sikurse shumë e mendojnë; përpara kanë qenë të gjithë të krishterë, por gjatë shekujsh pjesa më e madhe është kthyer në besimin

mohamedan. Shumë prej malsorëve janë katolikë, ndërsa në Shqipërinë e Jugut pothuajse kisha greke është krejtësisht e pranueshme përveç mohamedanëve. Gjuha shqipe është aq e dallueshme nga gjuhët tjera të Europës sikurse është gjuha Kelte dhe Baske. Ata s'kanë literaturë veçse pak libra të priftërinjve katolikë; as alfabet të qëndrueshëm nuk kanë akoma. Në shkollat e pakta turqit nuk kanë lejuar që të mësohet gjuha e tyre dhe nuk janë shumë ata që dijnë me shkruajtur e me lexuar. Historia e Shqipërisë është një shënim i gjatë shkeljesh, plaçkitjesh dhe gjakderdhjesh. Këngët e tyre tregojnë, theksojnë, vetëm lufta e trimëria. Të gjitha shkeljet e Europës mizore e kanë përhënë këtë vend me zjarrm e shpatë.

Mbasi vdiq heroji Gjergj Kastrioti që mbajti larg nga Shqipëria për 24 vjet ushtritë e sulltanit duke i zhdukur nga faqja e dheut njërën mbas tjetrës, otomanët mundën ta pushtojnë Shqipërinë dhe e mbajtën nën zgjedhë për më se 450 vjet. Përveç popullit të fushave, të cilët i ka vrarë më shumë zgjedha e robërisë, përgjithësisht Shqiptarët janë trima e luftetarë të fortë. Malësori nuk del kurrë prej shtëpisë së tij i pa armatosur, e deri bariu mban tufën e vet i armatosur deri në dhëmbë. Lufta ka qenë i vetmi besim i tyre; biles ata thonë: aty ku është shpata aty është besimi. Djali rritet pa farë edukate ose disipline përveç se përdorimit të armëve. Në ushtrinë turke ai mësoi se si me vjedhë e me grabitë; në shtëpinë dhe vendin e vet zyrtarët dhe tagrambledhësit e pengonin në kursimet,

punimet dhe industrinë. I rritur në një atmosferë dhune dhe vjedhje, edhe uriya shpesh here e ka shtërnguar të fitojë rrojtjen e tij si të mundet, qofte edhe prej armikut që i ka shkelë në votër. Nuk duhet shikuar për çudi pse vjedhja që i bënin turqve quhesh patriotizëm i lartë. Pa dyshim këta malësorë janë të egër dhe të pamëshirshëm në mësymje ose në mbrojtje. Që këta kanë edhe zakone të këqija s'ka nevojë për vërtetim, porse janë rritur në një atmosferë pesimiste.

Një popull fisnik

Ky popull është shembulli më i madh i të mbajturit të moralit dhe meritave të trashëguara, për fisnikërinë dhe për kapacitetin e tij që, megjithëse për shekuj me rradhë ka qenë nën ndikimin tiranik dhe zhvleftësues, e mban prap kryet lart, nuk i ka humbur shpresat e veta dhe gjithnjë thotë se jam Shqiptar, qoftë edhe në mes të zjarrmit. Dhe për këtë ky meriton të gradohet me një listë të gjatë virtytesh të pastërta e shembullore. San Xhiljano thotë se Shqiptarët janë egoista të radhës së parë. Sigurisht ata nuk janë një racë që shtrohen dhe kërrusen nga frika. Trimërija e tyre s'ka kufi; ata e përballojnë vdekjen dhe fatkeqsinë e tyre pa u trembur. Fjala e besës për ta është shumë më e shenjtë se sa bëmat e mëdha të popujve të qytetëruar dhe mikpritja e tyre vijon deri sa mos t'u mbetet më kurrgjë. Virtytet e grave të tyre janë të trashëguara dhe vdekja është dënimi i zakonshëm dhe i shpejtë në rast tradhëtie ose imoraliteti.

Ndjeshmëria e tyre në çnderime dhe fëmijë është shumë më i madh se sa në rrena e shpifje dhe këto raste mbarojnë gjithmonë në gjakmarrje. Në asnjë vend tjetër të botës nuk është ma e sigurve gruaja nga fyerjet se sa në Shqipëri; ai qe vret një grua bie nga vleftha dhe e humb emrin e famën. Bajroni e nderon në këtë mënyrë besnikërinë e Shqiptarëve nga përvoja vetjake që pati prane tyre:

T'ashpër janë djemtë e Shqipërisë,
e me gjithë këtë nuk u mungojnë virtytet,
të ishin ato virtyte më të pjekur;
Ku është armiku që ua ka pa shpinën e shtegun ta lirojnë?
Fortesat e shtëpitë e tyre nuk janë më të sigurtat kurrë,
sa ata vetë në kohëra turbullimi e në rast nevoje;
Sa e rëndë është mërija e tyre,
por kur ta falin, miqësia është fare e sigurtë;
Kur mirënjohja ose fisnikëria me derdh gjakun i thërret,
të patrembur shkojnë përpara kudo që t'i çojë udhëheqësi i vet.

Kaq tepër e admironte Bajroni këtë popull saqë Shelli e thërriste atë me emrin përkëdhelës ALBI. Malësori dallohet nga qytetari. Veshja përgjithësisht është si veshja kombëtare e Greqisë. Fustanella, një fustan i bardhë që mbërrin deri ke gjuri, çorape të bardha mbulojnë puplat e këmbëve, këpuce me maja të kthyeme e me tufa mbi ta, rrypi i mesit i mbushur me armë, xhamadani me mëngë të

lëshuara mbrapa dhe qeleshe. (Xhorxh Fred Uilliams ka vizituar vetëm bregun e jugor të Shqipërisë, prandaj përshkruan kostumin popullor jugor Shqiptar – shën. përkth.). Ky popull rron në formën prindërore, domethënë plaku i shtëpisë nderohet dhe shquhet përmbi të tjerët dhe të gjithë e dëgjojnë. Vajzat nderojnë dhe ndigjojnë nanën. Iu mbarohet më parë çdo dëshirë prindëve e pastaj të tjerëve. Tek ky popull nderimi për moshën është një tipar i veçantë. Janë shumë zemër mirë për njëri tjetrin, ndihmojnë shoqi shoqin në rast rreziku apo nevoje, kanë respekt për eprorët e tyre dhe e mbajnë besën me drejtësi e me ndërgjegje të pastër. Në mes të tyre flasin një gjuhë të zbukuruar, përdorin shprehje të pastra dhe të prishurit e gojës shpaguhet pa vonesë e ngadonjëherë shumë rëndë. As me qeshje nuk përdoret gjuhë përdhosëse.

Mikpritja është në kulmin e saj në Shqipëri. Një sulm po t'i bëhet mikut në çdo mënyrë qoftë, është një çnderim i madh për të zotin e shtëpisë e për gjithë fisin e tij. Ai që grabit ose vjedh mikun, sipas zakonisht të vendit dënohet shumë rëndë, ose me vdekje ose nxirret jashtë fisit. Burrat janë të gjatë, Gegët në Veri janë më të gjatë se Toskët në Jugë; gjithashtu më të fortë dhe më të rreptë. Një shkrimtar e përshkruan lëvizjen e malësorëve të Veriut si të dhive të egra që i ngjiten majave e shkëmbinjëve më të mprehtë dhe zbresin pa pikë frike nga këto vende, që kur i sheh thua se asgjë e gjalle s'mund të shpëtoje nga ato. Besa është tradita më e shenjtë; kur njëri ka besën e një

personi të mirë të njërit fis, çnderimi më i madh e pret thyesin e saj prej personit të atij fisi. Besa e Shqiptarit jo vetëm që mbahet dhe mbrohet me vullnetin më të mirë, por Shqiptari po të jetë nevoja jep edhe jetën për të mbajtur besën e dhënë. Një udhëtar nën fjalën e besës është nën mbrojtje të shenjtë.

Zakone gjakmarrje

Gjakmarrja është një traditë e Shqiptarëve, por e rregulluar mbas ca ligjeve dhe zakoneve të vendit që caktojnë kur, kush dhe si është e drejtë një gjakmarrje. Në këto raste qeveria nuk përzihet, edhe në qoftë se ndërhyr do të ndjekë zakonin e vendit më tepër se ligjin. Ky “lex talionis”, rregull që jep të drejtë që të shpaguehet një dëm i ndërsjelltë ose si i thonë, një sy për një sy e kokë për kokë, jo vetëm që hyri nëpër ligje gjatë shekujve, por edhe nëpër besime. Gjykohej se shpirti i të vrarit nuk ka qetësi deri sa të vritet gjaksori. Në Shqipëri familjes ose trashëgimtarve nuk u mbetet gjakmarrja vetëm për vrasje, por edhe për çeshtje nderi grash. Gjaqet shpesh herë shtrihen deri në bajraçe, fise, dhe shpagime gjaqesh shumë herë kanë kapërcyer katunde e krahina. Ligjet turke në këtë vend nuk jepnin ndonjë farë drejtësie; madje i nxitnin këto zakone pasi ato shkaktonin përçarje, grindje dhe armiqsira të mbrendshme ndërmejt Shqiptarëve, gjëra që i lehtësojnë barrën Turqisë për të zbatuar më tepër tiraninë dhe robërinë. Me ardhjen në fuqi të ligjit të

krimeve, ky zakon ndoshta do to zhduket me kohë sikurse në rastin e Malit të Zi.

Gratë Shqiptare

Ndërsa, si dhe në shtetet tjera të Ballkanit, gruaja bën të gjitha punët, si në fushë ashtu edhe në shtëpi, ajo shikohet më me respekt dhe zë një pozitë më të lartë se gruaja e Lindjes. Një grua mund të shëtisi prej një ane të Shqipërisë në tjetrën pa farë dyshimi, bile edhe një burrë që mund të ndodhet me të, nga shkaku i gruas është i sigurtë. Në qoftë se një vajzë e fejuar le të fejuarin e vet, ajo e ngarkon familjen e saj me një gjak të cilin e ka të drejtë i fejuari i saj. Përveç atyre të qytetit, nusja nuk merr pajë nga ati i saj, përkundrazi dhëndri i paguan një shumë të hollash të atit të vajzës; për gratë e veja paguhet gjysma. Ndër gratë Shqiptare dashuria dhe bukuria nuk luajnë një rol me rëndësi. Ç'ka ia shton rëndësinë gruas pranë burrit është të pjellurit; dukë shtuar femijët, shtohet edhe pozita. Nuk egzistojnë gjëkund gra më të virtytshme se në Shqipëri.

Brez i fuqishëm

Gjaku i Shqiptarëve është gjak burrërie. Shqiptari i ka dhënë Turqisë gjeneralët dhe ministrat më të mirë. Vëllezërit e tyre në Itali, Toskanët, vunë themelet e vertetë të madhështisë së Romës. Pesë perandorë të Romës qenë bij malësorësh Ilirianë; ata e forcuan racën Italiane. Në grykat dhe në malet

e Atikës gjuha Shqipe është në përdorim edhe sot. Në përpjekjet e Greqisë për liri, Shqiptarët lanë emra fame. Ata trazohen me të tjerët, por në trazim nuk bashkohen, domethënë nuk i përziejnë gjakun dhe zakonet e tyre. Të ruajturit e gjuhës dhe të zakoneve të veta nën thembrën dhe tiraninë e shekujve tregon mundësitë e një race të fortë e të pamundëshme. Do të shohim se si Europa e përdori këtë çelës të Ballkaneve për të mbajtur mbyllur dyert e mëshirës e të dritës mbi një popull, i cili tani po lutet për pavarësi e liri.

Ngatërresat e fuqive të mëdha

Djali im, ti nuk e di se me sa pak mëshirë qeveriset bota.

Uksensherna, kryeministër i Suedisë, 1612

Shqipëria, një vend kaq i vogël e i prapambetur, pa kurrfarë qytetërimi, pse luan një rol kaq të madh në politikën e Europës? Është e nevojshme që t'i pergjigjem këtu kësaj pyetje, pergjigjia e së cilës trajton përmbajtjen e ndërlikuar të diplomacisë Europiane. Pergjigjia e shkurtër është se situata gjeografike e Shqipërisë paraqet probleme politike edhe më të gjëra se ato të parashtruara prej shteteve të tjerë të Ballkanit. Gjendja e Shqipërisë është një faktor kryesor i problemit të Lindjes, mbasi kjo është udha natyrale e kalimit prej Adriatikut në Lindje. Përveç kësaj është edhe pikërisht vendi për daljen e tregtisë së Ballkanit dhe së fundi ajo ka në dorë komandën e hyrjes në

Aariatik në ngushticën e Otrantos. Portet e saja, me portin në detin Egje të Selanikut dhe të Bosforit, janë çelsat e dyerve të Europës Lindore për në detin Mesdhe. Për të marrë në dorë këta çelsa diplomacia e Europës ka punuar për dy shekuj rresht.

Përjashtimi i Ruisë nga deti Mesdhe

Përmbi të gjitha del e dukshme figura e Ruisë, qëllimi kryesor politik i së cilës ka qenë me patur kalim të lirë në detin Mesdhe. Për këtë qëllim ajo e pa të arsyeshme shkatërrimin e Turqisë. Në vitin 1711, Pjetri i Madh thirri në ndihmë shtetet sllave të Serbisë, Sllovenisë, Maqedonisë, Bosnjës, Hercegovinës, Kroacisë dhe Malit të Zi për t'u bashkuar me të në një luftë fetare e racore për të liruar të krishterët ortodoksë dhe gjithë popujt që flasin gjuhën sllave nga zgjedha otomane. Që prej asaj kohe, Rusia dhe Turqia kanë qenë në një ndeshje të përhershme dhe Rusia është bërë mbrojtësja dhe ndihmësja e shteteve sllave. Këto kondita iu paraqitën parlamentit prej Sir Eduard Greit (Ministër i Jashtëm i Britanisë), parlament i cili ishte vendi i zakonshëm i diplomacisë Europiane në të kaluarën. Është për t'u shënuar se shtetet që emëroi Cari i Madh, bashkë me Hungarinë dhe Poloninë, formonin një rreth të fortë popujsh sllave kundrejt Austrisë Gjermane. Ëndrra për t'i bashkuar këta popuj në një perandori sllave që një lumturi për Rusinë dhe Serbinë, por një tmerr për popujt Gjermane dhe për të gjithë Europën Perendimore. Nga frika e kësaj fantazme të

një perandorie sllave, fuqitë e Europës kanë ndenjur të bashkuara për të mos e lënë Rusinë e as aleatët e saj sllave me zënë vend ose me krijuar ndonjë kalim për në detin Mesdhe.

Por fakti kryesor që i takon Shqipërisë është se fuqitë Evropiane e përkrahën sundimin turk në Europë dhe e mbrojtën atë kundra Ruisë për të vetmen arsye se zhdukja e Turqisë nga Adriatiku deri në Stamboll do të shkaktonte ndarjen e këtyre vendeve fqinjëve të tjerë, dhe në këtë menyre do të hapej çështja e madhe e sllavëve për të dalë në detin Mesdhe. Lufta Krimesë u bë prej Anglisë dhe Francës për të mbrojtur Turqinë kundra Ruisë dhe përfundoi me traktatin e Parisit në të cilin pavarësia e Turqisë u garantua dhe u sigurua. Ajo u pranua që të marrë pjesë në marreveshjet e fuqive Evropiane, kurse popujt e krishterë të Lindjes u lanë nën mëshirën e dobët të Sulltanit. Ishte përpara kësaj lufte kur Car Nikolla parashtrroi që perandoria turke të mos njihej nga ana e Ruisë dhe Anglisë, por kjo e fundit nuk e pranoi këtë kërkesë.

Traktati i Berlinit

Në vitin 1878, Rusia pushtoi Turqinë dhe ndaloi në dyert e Stambollit. Traktati i Shën Stefanit u bë në mes të dy ndërluftuesve dhe me të cilin mjeshtërisht Rusia për të mirën dhe përdorimin e vet krijoi një shtet të madh Bullgar, që nga ana Jugore do të shtrihej deri në detin Egje duke

përfshirë edhe portin e Selanikut. Kjo shkaktoi mbledhjen e shpejtë të fuqive Europiane të cilat bënë traktatin e Berlinit. Ky traktat ndaloi formimin e shtetit Bullgar të projektuar dhe vuri në heshtje kërkesat e Rusisë për të pasë një port në detin Mesdhe. Serbia, Rumania dhe Mali i Zi u shpallën shtete të pavarura. Një hartë e kohës së fundit do të tregojë se traktati e la një copë të Ballkanit akoma nën sundimin turk, e cila shtrihej prej Adriatikut deri në Stamboll dhe përmblihte Bosforin, Selanikun, Maqedoninë dhe Shqipërinë. Shtetet sllave të Bosnjes dhe Hercegovinës në Adriatik iu dhane Austrisë. Qe një këmbëngulje e vendosur për Europën që të mos lejonte shtet sllav të kishte një dalje në detin Mesdhe. Skllavëria dhe robëria e të shkretës Shqipëri nuk u bisedua; kjo ishte viktima e parimit të kësaj diplomacie të Europës.

Kongresi i Berlinit - Qershor 1878

Kërkesat e Serbisë në Adriatik

Lufta Ballkanike më 1912 nuk u prit me sy të mirë nga fuqitë Europiane. Historia e saj është e njohur por nuk është kuptuar krejtësisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës se dy gjërat më me rëndësi të kësaj lufte ishin marrja e portit të Selanikut dhe të porteve të Shqipërisë. Këta ishin vend-daljet natyrale të tregtisë së Ballkanit dhe vend-shkarkimet e hekuradhavë të ardhshme. Edhe Austria priste me padurim ndonjë rast për të shtirë në dorë portin e Selanikut, por shteti serb kërkonte

mbi gjithë të tjerat një port për lëvizjen tregtare të tij. Ajo ishte e mbyllur dhe e izoluar larg detit dhe në qoftë se shkeljes së tokave të huaja i jepte të drejtë, Serbia pa turp mund të kërkojë një vend-dalje në det. Grindja e shteteve të Ballkanit në mes tyre u bë shkak që gjashtë fuqitë e mëdha të Europës të marrin në dorë frenat dukë ndërhyrë që t'i pushonin këto grindje.

Austria dhe Italia rivale

Në këtë kohë duhet përmendur edhe një fazë tjetër trazimesh në Shqipëri. Austria dhe Italia urdhërojnë ose komandojnë detin Adriatik përveç ballit të Shqipërisë. Këta dy shtete kanë pritur me padurim vite me rradhë rastet për të shtirë në dorë portet e këtij vendi. Ata kanë shpenzuar të holla duke mbajtur në Shqipëri agjentë dhe shkolla për të shtuar ndikimin e tyre mbi këtë popull. Të dy këto kanë pritur ditën kur “i sëmuri i Lindjes” do t’u varrosej në anën tjetër të detit Egje. Mbi dy pika Austria dhe Italia qenë posaçërisht në marrëveshje: e para, që asnjëra prej tyre të mos sundonte Shqipërinë dhe e dyta që asnjë fuqi tjetër të mos vendosej në Adriatik. Nga pikpamja diplomatike e përgjithshme, kjo nuk qe një gjë shume e pa arsyeshme. Pse, po të kish nën sundimin e vet Austria Shqipërinë, ajo do të gjendej vetëm 74 km larg bregut Italian në mës të Vlorës dhe Otrantos. Dhe, po të bëhej Italia sunduese e Shqipërisë, do ta kthente Adriatikun në një gji të Italisë duke e bërë “il mare nostra”, sikurse

italianëve u pëlqen ta thonë. Në anën tjetër, çdo fuqi detare me zotërimin e Shqipërisë do të ishte një kërcënim e kanosje për të dyja, Austrinë dhe Italinë.

Perandoria sllave

Plani për një perandori sllave ushqehesh më tepër prej Serbisë nën emrin e krijuar “Serbia e Madhe”. Edhe Mali i Zi është bashkuar me këtë plan; që të dy duke qenë nën kujdesin e Rusisë, mbrojtëses së tyre të betuar. Me një perandori të tillë, provincat sllave, Bosnja, Hercegovina dhe Dalmacia, më lejen ose hapjen e Austrisë, do të bënin të mundur daljen e Malit të Zi dhe të Serbisë në Adriatik. Shumë u zemëruan këto shtete kur më 1908 Austro-Hungaria zgjeroi sundimin e vet mbi Bosnjen dhe Hercegovinën dhe i bëri kryekëput të vetat. Kur të gjashtë fuqitë e mëdha e patën mbaruar Konferencën e Londrës mbi ndarjen Ballkanike, ato ndoqën po ata parimet e vjetra për të mos lejuar shtetet sllave me takuar detin Mesdhe. Turqia pothuaj se qe terhequr nga Ballkani dhe një problem i madh gjendej mbi tryezën e fuqive Europiane. Këto e zhvilluan këtë duke i dhënë portin e Selanikut Greqisë dhe duke krijuar shtetin e pavarur të Shqipërisë. Në këtë mënyrë varroseshin shpresat e Serbisë, e cila në këtë kohe është çuar në këmbë dhe ka shkelur Shqipërinë ndërsa Mali i Zi ka pushtuar Shkodrën.

Shqipëria dhe lufta botërore

Në këtë plan veprimesh Austria dhe Italia ishin pa kundërshtim fuqitë lëvizëse dhe princi trashëgimtar Franz Ferdinandi i Austro-Hungarisë shikohej si kujdestar i parimit të tyre. Serbia mjaft e zemëruar që prej vitit 1908, tani u tërbua dhe pa dyshim demonstratat e saja kundër Austro-Hungarisë qenë të rrepta dhe kërcëuese për hakmarrje. Qellimi i gjallë i Europës për të përjashtuar Rusinë dhe aleatët e saj nga deti Mesdhe shihet edhe nga fakti se kur Austro-Hungaria mori Bosnjen dhe Hercegovinën për pak qe duke u shkaktuar një luftë Europiane dhe vepra e krijimit të shtetit të pavarur Shqiptar sigurisht qe duke ndezur një ndeshje të përgjithshme. Mëria e madhe kundra Austro-Hungarisë natyrisht iu drejtua princit trashëgimtar dhe vrasja e tij në Sarajevë keqësoi pa masë marrëdhëniet midis Austro-Hungarisë dhe Serbisë. Mbas kësaj, ngjarjet rrodhën shumë shpejt. Austro-Hungaria i diktoi ultimatum Serbisë dhe me kundërshtimin e tij i shpalli luftë. Rusia qiti zërin se kjo ishte puna e saj dhe brenda pak diteve pesë prej fuqive të mëdha u gjendën në ndeshje të vazhdueshme. Po të kish përmbushur Europa dëshirat e Serbisë për një skelë në Shqipëri, kjo klimë e tmerrshme nuk do të vinte. Zotërimi ose sundimi mbi Shqipëri qe pa dyshim shkaku që u shkaktua kjo luftë që po përfshin kontinentin e Europës. Kjo është historia e diplomacisë Europiane në Ballkan, me gjithë se shumë shkurt është përshkruar. Prandaj përshtatet posaçërisht titulli "Ngatërresat e Fuqive të Mëdha".

Shqipëria etnike

Faji i diplomacisë Europiane

Në qoftë se me të vërtetë bashkimi sllav është një kanosje për qytetërimin Perëndimor, sigurisht historia e diplomacisë përkundrazi ndryshon kur Rusia të ketë siguruar aleatë të fuqishëm në Perëndim për shkatërrimin e Gjermanisë, pengesën më të madhe të triumfit të saj. Por në qoftë se ky bashkim është vetëm një përrallë e shpikur ose një arsyetim jo i vërtetë, atëhere diplomacia Europiane duhet të quhet fajtoreshë ndaj krimit që bën duke mbajtur Ballkanet nën zgjedhën e dobët të Turqisë. Në njërin anë prej këtyre dy çengëve, që janë përgjigjia e këtij problemi, duhet të varet kjo lloj diplomacie. Edhe në qoftë e vërtetë se kanosja sllave që një pretendim dhe që shtetet e mëdha deshën vetëm me gjetur shkak për të mbajtur Rusinë larg nga deti Mesdhe, vuajtjet dhe fatkeqësitë e Shqipërisë varen mbi dyart e tyre sepse Shqipëria vuajti vetëm prej fajit të tyre. Me të vërtetë me sa pak mëshirë qeveriset bota! Po to kish prishur Europa një shekull më parë sundimin otoman në Europë, patjetër faqja e qytetërimit tonë do të ishte ndryshe. Shtetet e Ballkanit do të kishin tashmë një shekull vjetërsi në lirinë e tyre dhe mundet që në rrugën e paqes do të ishin më të përparuar në pasuri, në edukatë, në tregti dhe industri. Përkundrajt të sotmes që janë të varfër e të shkatërruar prej luftash të vijueshme, të cilat

janë shkaktuar vetëm e vetëm pse kërkonin të liroheshin nga zgjedha. Shqipëria tani do të mund të ishte një shtet i lulëzuar e i përparuar. Ndoshta kur diplomacia e zezë, që ka rrënjët në shekujt e errët e që bën çdo shtet të shihet me tjetrin me një armiqësi të madhe, të jetë zhdukur dhe ndonjë mënyrë simpatie njerzore dhe vllazërore të përdoret, atëhere do të kujtojmë faktin që suksemi i një populli nuk është nevoja të bëhet me humbjen e një tjetri. Atëhere sllavet, gjermanët, anglezet, turqit dhe Shqiptaret mund të përfitojnë shumë më mirë nga përparimi, lulëzimi dhe lumturia e njëri-tjetrit.

Diplomacia e shastisur e Europës

Ndërkaq Shqipëria, viktima kryesore e kësaj diplomacie, mbetet e lodhur, e kërrusur dhe e zhytur në gjak sepse, edhe mbas lirit të shteteve tjera të Ballkanit nga zgjedha, kjo u la akoma nën Turqi. Bashkë me Shqipërinë mbeti nën zgjedhë edhe Maqedonia. Po të kishte mbetur ndopak simpati njerzore në politikën e Europës dhe ndonjë ndjenjë për të shpague mëkatet që ka bërë gjatë shekujve, këto fuqi do t'u kishin dhënë rastin Shqiptarëve për të formuar një qeveri dhe për të zbatuar një statut të vetin. Edhe një dhenzë e truve të kalit do të kishte menduar që një popull trim dhe luftëtar si ky nuk do të pranonte një zgjedhë tiranie të re në vendin e së parës. Por diplomacia e shastisur vendosi të zbatojë forcën dhe tiraninë për të sunduar këtë popull; por ky vendim doemos do të binte poshtë sikurse u pa. Shtetet e Europës

kanë bërë titur dhe kanë shpallur se Shqiptarët janë popull i pabindur, i egër e barbar. Por në anën tjetër deshën të krijojnë mbi ta një qeveri pa pyetur dëshirat e tyre, pa iu siguruar ndonjë farë lirie ose të drejta trashëgimore dhe biles pa asnjë këmbë ushtari për të vënë në zbatim programin e tyre: sollën vetëm disa oficerë, kurse ushtarë jo. Por, po të ishin të vërteta deklaratat e tyre, ata do të kishin sjellur fuqi të madhe të armatosur për të perkulur Shqiptarët; por këto të bërë titura ishin vetëm për të justifikuar sjelljet e tyre. Ata prenë copa me rëndësi nga toka Shqiptare dhe ia dhanë fqinjëve në Veri, në Jugë dhe në Lindje, duke shkaktuar kështu ngatërresa dhe luftëra të përditshme në mes të këtyre shteteve. Copën që mbeti nga gërshëra e tyre e quajtën shteti i pavarur i Shqipërisë. Gabimin më të madh të planeve të tyre do ta përshkruaj në kreun që vijon.

Shqipëria është bërë lëmi i ndikimeve të shumëllojshme që e tërheqin në drejtime të ndryshme. S'ka vullnet, s'ka program e as autoritet të njohur në këtë tokë. Propaganda, intriga dhe shpifjet e fshehin të vërtetën.

Këtë e raporton Dr. Dillone nga Durrësi.

Kur gjashtë fuqitë e mëdha hartuan një plan qeverimi për Shqipërinë, vepra e tyre tregoi një pazotësi të çuditshme, sepse ai që një plan që i nuk përshtatesh një shteti si ky. Marrëveshja e Londrës përmbante nenet:

(1) Një principatë autonome, sovrane, me të drejtë trashëgimi të fronit nga të paslindurit dhe nën sigurimin e gjashtë fuqive të mëdha.

(4) Kontrollimi i administratave qytetare dhe i financave i jepet një komisioni ndërkombëtar të përbërë prej delegatësh të gjashtë fuqive të mëdha dhe një delegati të Shqipërisë.

(7) Emërimi i princit, formimi i një qeverie kombëtare përfundimtare, funksionet e autoriteve të vendit që ndodhen si dhe qetësija e popullit i lihen në dorë komisionit në fjalë.

(8) Sigurimi i popullit dhe rregulli do të bëhet prej një organizate xhandarmërie e policie ndërkombëtare, që do të jetë në dorë të oficerëve të huaj të cilët do të kenë në dorë komandën vepruese dhe eprore të policisë e të xhandarmërisë, dhe të gjithë elementëve të nevojshëm për të siguruar qetësinë e popullit.

I lutem lexuesit me i studiuar këto pika që të formojë një vetgrykim se si mund të formohet një shtet mbi një plan si ky? Tre funksionet e një shteti janë: egzekutimi, legjislatura dhe administrimi i gjyqit. Shihet se dy të fundit nuk janë përmendur veçse si një lloj autoriteti i lënë komisionit ndërkombëtar për të formuar një qeveri kombëtare me autoritet. Funkzioni egzekutiv natyrisht përfshin një kryetar egzekutues që do të ketë kontrollimin e administratave qytetare dhe të sigurimit të popullit. Marrëveshja (e Londrës) përmban një princ, por ia dha komisionit ndërkombëtar kontrollimin e administratave

qytetare dhe të financave. Dhe në një të anë e vendos sigurimin e popullit nën komisionin ndërkombëtar, kurse në anën tjetër thotë: “komanda vepruese dhe eprore për të mbajtur qetësinë e popullit i jepet një organizatë ndërkombëtare të kryesuar prej oficerësh të huaj”. Se çfarë fuqirash i mbeten princit nuk kuptohet, kurse administratat, financat dhe siguri i popullit iu dhanë duarve të tjera. Sipas vendimit të marrëveshjes (së Londrës), princi do të zgjidhesh pa pyetur dëshirat e popullit dhe funksionet e autoriteteve të vendit e siguri i popullit u hoqën nga duart e popullit. Nuk qe vënë përpara ndonjë statut në bazë të cilit të qeverisej ky popull dhe asnjë premtim nuk i qe bërë për një liri të plotë ose për të ushtruar të drejtat tradicionale. Këtu qe vetëm një sundim tiranik dhe një despotizëm të deklaruar me urgjencë. Me sa gjykohet, kjo qe një anarki për të shkaktuar kryengritje. Po të mos ngrihesh populli Shqiptar në formën e quajtur rebelizëm, për Shqiptarët nuk do të besohej mjaft dhe do të thuhej se këta nuk kanë ide mbi lirinë që kërkojnë. Nga kjo marrëveshje e Londrës doli një ngatarresë sa nuk bëhesh më e madhe dhe më e keqe. Fuqitë e mëdha pastaj vijuan programin e tyre duke zgjedhur për antarë të komisionit gjashtë persona me pozita konsujsh. Pa e fyer këtë pozitë diplomatike, kjo vepër qe një punë e keqe sepse lëshimi i një shteti në duar të tilla nuk qe në duar të njerëzve me përvojë diplomatike. Sigurisht, që formimi i një shteti nuk u vendos në duar të përshtatshme tregohet nga fruti i veprës së tyre.

Qeveria e Vidit

Si princ i kësaj principate u zgjodh Uilliami i Vidit, major i gardës Potsdam Lancers, një zotëri pa farë përvoja në qeverisje dhe pa vetitë e duhura për një kryetar shteti. Ai qe nip i Mbretëreshës së Rumanisë, e quajtur Karmen Silvia, dhe duhet shënuar se përkrahja financiare dhe shtyrja e saj si dhe detyrimi i gruas se tij ambicioze u bënë shkak që ky të pranojë këtë detyrë. Tragjedia e gabimeve filloi para se të vinte Princi në Durrës. Esad Pasha, kryetar i ca fiseve të Shqipërisë së Mesme, pa pasur autorizim prej popullit, shkoi në mënyrë solemne dhe i dhuroi kurorën Princit Vid në emër të Shqipërisë. Që në ditët e para tërhoqi vërejtjen një zënie midis nëpunësit të pallatit me mjekun e oborrit, e cila përfundoi me ikjen e shpejtë e shumë zemërueshem të mjekut nga Shqipëria. Komisioni Ndërkombëtar në bazë të marrëveshjes së Londrës priste që princi të vinte me bashkëpunuar me të për të zgjidhur problemet e ndryshme të shtetit. Por shpejt e mësua se Vidi po vinte si mbret dhe kishte kërkuar që të pritet me gjithë madhështitë që i kanë hije një pritjeje mbretërore. Kur ata deshën të bëjnë ca paragatitje dhe për këtë deshën të bashkëpunojne me nëpunësin e pallatit, ai u përgjegj se nuk kishte kohe me humbë me ta. Se me ç'të drejtë Princ Vidi e mori titullin mbret askush s'ka qenë i zoti ta shpjegojë. Ai në marrëveshjen e Londrës figuron si Princ.

Princ Widi me qeverinë e tij në Durrës 1914

Në fjalimin e tij mbretëror (!?) princi theksoi se do të mund të kishte rast me bashkpunuar me komisionin ndërkombëtar, kurse marrëveshja (e Londrës) e thotë që ai duhet të bashkëpunojë. Qeverimi ose mbretërimi filloi duke i ofenduar haptazi përfaqësuesit e fuqive të mëdha, të cilët kishin në dorë portofolin dhe pothuaj gjithë autoritetin, (sepse ata kishin kontrollin e financave dhe të administratave - shën. përkth.). Princi emëroi një kabinet, por ministrat e tij nuk kishin autoritet të caktuar ose të dalluar dhe në këtë mënyrë çdo gjë që morën përsipër komisioni e kundërshtoi. Ndërkaq epirotët, që zenë Shqipërinë e Jugut, deklaruan pavarësinë e tyre. Esad Pasha kërkoi 25000 vetë të armatosur për t'i shtruar këta, por ushtarë nuk kish. Koloneli hollandez Tompson që kishte komandën e xhandamërisë u ngarkua me mision prej princit për të bërë marrëveshje me "epirotet". Ai fitoi besimin e tyre dhe erdhi në një marrëveshje shumë të mirë, por Esadi siguroi mohimin e misionit të kolonelit nga ana e kabinetit dhe ky mision u flak edhe prej princit. Më vonë kur komisioni ndërkombëtar bëri marrëveshje në Korfuz me kryengritësit e Jugut, antarët protestuan se ky komision nuk dinte kurrgjë mbi marrëveshtjen e kolonelit Tomson e as mbi misionin e tij.

Kur unë erdha në Durrës, njëri prej antarëve të komisionit më mohoi pikat më kryesore të marrëveshtjes së Korfuzit, një kopje të së cilës ia

paraqita të vërtetuar prej sekretarit të komisionit. Në këtë mënyrë vijonin punët në krijimin e një shteti. Mbledhjet e komisionit bëheshin edhe më të vështira nga mosmarrëveshjet dhe ngatërresat në mës të përfaqësuesve të Austrisë dhe Italisë, të cilët mundoheshin me ia hedh fajin njëri-tjetrit. Kabineti edhe ky u nda dhe në Maj të vitit 1914 Esad Pasha, ministër i luftës, u arrestua si komplotist kundër qeverisë, u vu në një luftanije të Austrisë dhe u dërgua në Itali. Në anën tjetër, Shqiptarë kryengritës, rebelet, me armë në dorë u dukën para dyerve të Durrësit. E vetmja kërkesë e tyre ishte që princi të lejë Shqipërinë dhe prej asaj kohe e deri në fund ajo ka qenë britma e tyre për çdo marrëveshje që thirreshin me bërë.

Duke vënë fenë si shkak për lëvizje luftarake

Një njeri me mend nuk do të kishte pranuar detyrën me ushtruar tiraninë mbi një popull luftëtar si ky pa qenë i siguar nga fuqitë e mëdha se do t'i japin forca ushtarake, sepse gjithë themeli i kësaj pune ishte forca. Biles, edhe kur vendasit u ngritën me armë në dorë kundër tij, e para gjë që duhej të bënte qe që të kërkonte fuqi të armatosur ose të linte Shqipërinë duke u kthyer në vendin e tij. Por kur vendasit mohamedanë e kundërshtuan atë me armë, ai mori me pagesë malsorë katolikë të Veriut për të mbrojtur Durrësin. Edhe mohamedanët e Vlorës u vunë në ndihmën e princit, ca nga të cilet u lanë për të kundërshtuar kryengritësit e Jugut dhe të tjerët u prunë në

ndihmë të Durrësit, kundër kryengritësve të Shqipërisë së Mesme. Problemi më i madh i një qeverie në këtë vend është për të prurë në marrëveshje ose për të bashkuar elementët e besimeve të ndryshme me qëllim që të zhduket sa më parë kundërshtia në mes tyre e cila ka qenë futur prej sundimtarve turq. Brenda pak javësh sundimi të Princ Vidit, gjendja u bë shumë e keqe. Në Shqipërinë e Jugut mohamedanët vritnin ortodoksët e në Durrës malësorët katolike thernin mohamedanët brenda pamjes se pallatit të princit, i cili ishte i sigurtë vetëm nën grykat e zjarrit të topave të luftanijeve të fuqive të mëdha që ishin në molin e Durrësit vetëm për të mbrojtur princin dhe familjen e tij. Dukej haptazi se pa u bashkuar për bashkëpunim elementët e besimeve të ndryshme, qeveria e tij ishte më kot.

Vidi u ngul në Durrës më 21 Shkurt 1914 dhe më 24 Maj të këtij viti, mbas një mesymje nga kryengritësit, ai me familjen e tij fluturoi në kryqzorin italian Misurata. Megjithatë të nesërmen u kthye prapë në pallatin e vet, por ikja që kish bërë një ditë më parë prej qyteti në luftanie ia humbi rëndësinë dhe e bëri të pamundur që ai të kishte pamjen si sundimtar i një populli ndaj të cilit burrëria, zemra dhe trimëria janë gjëra fare të zakonshme. Një veprim i vogël i komedisë u luajt më 5 Qershor kur në drekën e kësaj dite luftania Tegelhoff duhej të dëfrente princin. Një ceremoni mbretërore që paramenduar dhe ministrat e pranuan, por atë ditë komisioni ndërkombetar po

mundohej për të ardhur në marrëveshje me kryengritësit e për këtë kishin frikë se mos alarmoheshin dhe dëshpëroheshin këta nga krismat e topave. Komisioni doli fitues në ndalimin e ceremonisë, por jo me kryengritësit të cilët nxirnin të vetmen fjalë: “princi lipset të shkojë nga toka e jonë”. Në anën tjetër të gjithë degët e fuqive sunduese çdo minute vinin në mosmarrëveshje më të mëdha dhe ngatërroheshin më keq në mes tyre. Disa ia ngarkonin gjithë shkakun e ngatarresave oficerëve hollandezë, të cilët kërkonin me patur fuqinë eprore dhe jepnin urdhëra mbi ata të qeverisë së rregullt. Prandaj më 22 Maj, anëtarët e kabinetit shkuan si një grup dhe i dhanë dorëheqjen mbretit duke thënë haptazi se nuk durojnë të përdoren më si kukulla në duat e oficerëve hollandezë dhe të marrin përsipër gabimet trashanike dhe keqbërëse të tyre. Por në anën tjetër në këtë kohë oficerët hollandezë ishin të vetmit mbrojtësit e Durrësit duke komanduar malësorët shqiptarë, gjuhen e të cilëve as që e kuptonin. Ditën e 15 Qershorit komandant kolonel Tompson u vra dhe me qinda njerëz u vranë në kënetë.

Ngatërresa në Durrës

Mbërrita në Durrës me datën 18 Qershor. Gjatë një jave që kalova në Gjirokastrë me kryetarët e kryengritësve unë pata mësuar për vrasjen e 70 mohamedanëve të pa armatosur, të cilën komisioni e kishte vërtetuar por kryengritësit e mohuan dhe e pata vurë vehten në dijeni me gjithë

mosmarrëveshtjet që qëndronin në mes të “epirotasve” dhe komisionit nderkombetar për të bërë paqe. Unë jo vetëm që u habita, por edhe u tmerrova për ngatërresat që gjeta në Durrës. Secili anëtar i komisionit ishte me armë në dorë kundra tjetrit dhe në vend që të ndëgjoni lajmet e dobishme që solla unë, secili e shkonte kohën duke më përshpëritur në vesh gjërat pa mend dhe keqbërjet e tjetrit. Asnjëri nuk kishte as më të voglën ide se kush e kishte sundimin ose komandën më të lartë, e cila kërkohet me një farë autoriteti nga princi, nga komisioni, nga oficerët hollandezë dhe nga kabineti. (Sepse marrëveshja e Londrës e kishte zhytur këtë punë duke ia dhënë në njërin anë komandën njërit e në një tjetër tjetrit, herë komisionit e herë Princit e herë oficerëve hollandezë – shën. përkth.).

Me i përshkruar hollësisht e ngatërresat që çdo ditë u bënë edhe më të këqija në Durrës, nuk do të ishte edhe aq e dobishme. Qeveria shkoi një herë në Vlorë dhe iu desh me u kthyer prapë në Durrës për arsye kompletoresh dhe aty gjeti kryengritjen e Esad Pashës. Një oficer italian u zu natën në Durrës duke i bërë shenjë kryengritësve e në këtë mënyrë duke iua drejtuar udhët e operacionit. Kur e arrestuan u gjet se ai që duke bashkëpunuar me oficerin që kish pas qenë ngarkuar me mision nga Princi për të mbrojtur Durrësin nga kryengritësit; atëherë misioni u pezullua. Një oficer hollandez më tha se Princit nuk mund t'i mbushej mendja kurrësesi për t'i prirë ushtrinë e as me u dukur më

para luftës. Luftaniet e gjashtë fuqive rrinin në një qetësi të vdekur në port. Kur qyteti u mësyë, komandantët e tyre u thirrën për të shtirë ca topa sa me trembur kryengritësit, por ato kundërshtuan duke thënë se kanë urdhëra të rrepta me vepruar vetëm për mbrojtjen e personit të princit e të familjes së tij. Kjo tregoi qartazi se fuqitë e mëdha kishin vendosur mos me shtirë asnjë top për mbrojtjen e qeverisë që kishin marrë përsipër me themeluar. Përvoja ime e fundit në Durrës që një natë para se të largohesha, kur qeshë zgjuar prej një krisme të tmerrshme pushkësh në kënetë pothuaj nën dritaret e mia. Oficerët më lajmëruan në mëngjes se kishin dërguar nja 15 vetë nëpër kënetë për të kërkuar të vranë e të plagosur, por njerëzit e tyre duke i kujtuar këta se ishin armiku që po iu afrohet, shtine mbi ta dhe i vranë të gjithë.

E lashë këtë skenë mëkatesh, ngatërresash të ndyra dhe gjakderdhjesh me një zemër plot mëri kundër krimit të madh të Europës dhe plot simpati për popullin që iu desh me derdhur gjak për të mbajtur larg zgjedhen dhe një nga gabimet më skandaloze në historinë e Europës. Tre muaj pas kësaj, princi, familja e tij, oborri e kabineti i tij, komisioni ndërkombëtar, ministrat e huaj, xhandarmëria dhe luftanijet ikën nga Durrësi dhe Shqipëria u la sikurse është sot, pa qeveri. (Domethënë në kohën e Luftës I Botërore – shën. përkth.).

Masa për shpëtim

Të nesërmen, pasi pata lënë Durrësin mbërrita në Vlorë. Kryetarët e Vlorës ishin besnike të princit Vid dhe i patën dhënë ushtarë për të luftuar kyengritësit e Shqipërisë së mesme dhe “epirotet” në Jug të Vlorës. Prandaj këta gjindeshin në një frikë të përditshme prej ndonjë mësymjeje nga vëllezërit e vet. Që mos të vazhdohej më rrënimi në mes tyre, i këshillova që të shpallin pavarësinë dhe të bëjnë paqe me vëllezërit e vet. Në emër të tyre shkova në Delvinë dhe takova kryetarin e qeverisë së perkohshme të Epirit, Zografo, i cili ishte i sëmurë në zemër pasi po kthehesh nga varrimi i 14 djelmohave Delvinnjotë që sapo ishin vrarë në shpat të malit, ndërsa 40 burra shtriheshin të plagosur. Ai qe gati me bërë paqe me vlonjatët dhe kur ky lajm mbërriti Vlorën u prit me shumë kënaqësi dhe duartrokitje. Atë mbasdreke dy luftanije të fuqive të mëdha që bënin pjesë në komisionin ndërkombetar, u ngulën në port dhe nën hijen e topave të Europës nuk lejuan bashkimin që unë kisha parashtruar. Ata e dinin mirë që qeveria e tyre po kotesh mbi fronin e saj dhe se do të binte. Po ashtu e dinin që përmbajtja e veprave të tyre do të shkaktonte edhe më shumë gjakderdhje vllazërore. Prej asaj kohe e mbrapa fuqitë “epirote” dhe kryengritsit e Shqipërisë së mesme përparuan. Më tepër se 100'000 barinj dhe bujq, gra, burra, fëmijë dhe foshnje lanë shtëpijat e tyre, të cilat ua dogjën e ua shkatërruan dhe këta vetë emigruan në Vlorë. Kur unë u largova nga Greqia, sëmundja e lisë po përhapej nëpër këta

emigrantë që pa ndihma dhe pa shpresë vdisnin në qarkun e Vlorës. Pak mbas largimit tim, u raportua se nga këta 100'000 emigrantë 30'000 kishin vdekur urie dhe s'kishin as mbulesë e as kasolle ku me shtirë kryet. Jam informuar që nëpër gjithë Shqipërinë ka zi. Në pranverë nuk ka me patur misër për farë për ata që do të shpetojnë.

Zbulimi i padrejtësisë

Mirë do ishte po ta kishte përshkruar gazeta Times e Londrës skenën e Durrësit si një komedi tragjike, që brenda pallatit mbretëror luheshin shakatë cinike më të mëdha, që mbrapa maskave buzëqeshëse të diplomatëve të Europës fshiheshin fytyrat e errta e kriminele, shkaktare të vdekjes së këtyre njerëzve, se jashtë në kënetë shtriheshin qindra Shqiptare mbrojtës të vatrave të veta, të fortë e të ngrirë, me sytë e tyre dhimbisurisht të drejtuar kah qielli i cili dukej e pamëshirshëm për ta. Dukesh një detyrë njerëzore, haptazi, me shqyer maskën që mbulonte diplomacinë Europiane e me nxjerr fytyrën e saj të lyer me gjak atdhetarësh dhe shikimin e dobët të saj mbi dëshirat e zjarrita për liri të një race të fortë. U ktheva në Athinë dhe pasi qeshë i shtrënguar e tregova këtë panjerzi dhe këtë padrejtësi të fuqive Europiane dhe dhashë dorëheqjen si minister i Amerikës në Greqi e në Mal të Zi, sikurse patjeter qeshë i shtrënguar me bërë. Drejtësia dhe e vërteta nuk janë mbrojtje në sallat e diplomacisë!

Qe shorti im me ngritur perden që t'i jepja dritë kësaj komedie, e cila që loja më tragjike që është vu në skenë prej duarve të njerëzve. Ky veprim që ai që me ka hapur rrugën me iu lutur popullit të lirë të Amerikes të ndihmojë Shqiptarët që po mundohen me luftë e me vdekje për lirinë dhe pavarësinë e tyre. Kur Europa, e përgjakosur, e mjeruar, e shfarosur, e falimentuar dhe e këputur do të hyjë duke çaluar në një periudhë të re qytetërimi, atëhere le të mësojë prej vuajtjeve të veta mëshirën që duhet të ketë për kombin e vogël malësor; e cila dëfrehesh me shtërngimet e shpirtit e me britmat e vdekjes së tij dhe vepronte paturpësisht duke i quajtur asgjë tmerret dhe vuajtjet e këtij populli për liri dhe humbjen e lirisë të një populli e quante një sakrificë të zakonshme për qejfin e tyre.

Përpjekjet për liri

Çdo popull i shtypur ka të drejtë të shkundë zgjedhën e tij dhe në qoftë se Shqiptarët janë mërzitur e lodhur nga zgjedha turke dhe qeverimi i keq i saj dhe dëshirojnë me qenë të pavarur, kanë urimet e mia më të përzemërta për ta. Është e vërtetë që drejtpërsëdrejti nuk mund të bëj kurrgjë për ta, por kur plani i juaj ka dalë me të vërtetë fitues, flamuri turk të jetë zhdukur dhe pavarësia Shqiptare të jetë shpallur, le të deklarohej qeveria juaj zyrtarisht dhe Anglia do të jetë e para fuqi që do njohë pavarësinë Shqiptare. Unë do të mundohem me gjithë shpirt me ndikuar edhe mbi të tjerët që të ndjekin këtë shembull.

Gladstone, Kryeministër i Britanisë, 1880

Për sa përmban historia e re, kjo është fjala më e mirë për Shqipërinë e dalur nga një burim zyrtar. Kjo kishte të paktën shpirtin e simpatisë dhe në qoftë se Kryeministri i tanishëm i Anglisë thotë kaq e jo më tepër për formimin e një qeverie të perkohshme në Shqipëri do të jetë një punë e lehtë për ta bërë Shqipërinë të lirë dhe të pavarur. Kur kam folur për robërinë e Shqiptarëve nën Turqi, nuk kam patur në mendje mizori, tortura, vrasje dhe therje. Këto veprime bien mbi persona të veçuar të cilët vuajnë, vdesin dhe harrohen. Shkenca e torturës, thelbi i tiranisë dhe djallëzia e vrasjes janë në kulmin e tyre kur i drejtohen një grupi dhe shpirtit e jetës së një shteti. Duket si e pamundur që një qeveri të tregojë haptazi vendimin e vet për të shkatërruar lumtërinë e për të mohuar shpresat dhe dëshirat e një populli nën sundim. Por kjo është historia e tmerrshme e Turqisë në Shqipëri. Malësorët trima nuk u shtruan kurrë dhe shumica e tyre kundërshtuan edhe pagesen e taksave. Ata vdisnin në grupe pse rrinin së bashku për t'u mbrojtur nga mësymjet e herë pas herëshme të ushtrive turke, të cilave kurrë s'ia lëshuan shtëpitë e tyre. Por ata nuk mund të rribronin edhe fushat ku ishte mundësia më e madhe e përparimit dhe qytetërimit. Për Turqinë, fushat kishin dy vlera: e para si burim të ardhurash dhe e dyta për të mbledhur ushtarë. Popullit i vinin taksa të mëdha që i mblidhnin pa mëshirë. Taksat dërgoheshin në Turqi dhe shumë pak shpenzoheshin në vend. Në

këtë mënyrë e ropi Turqia pasurinë e vendit. San Xhuliano, tani vonë ministër i jashtëm i Italisë, thotë se qyteti i Vlorës paguante 1'000'000 franga në vit dhe vetëm 20'000 shpenzoheshin aty. Gjithashtu edhe në Vilajetin e Janinës mblihdeshin 9'000'000 franga, prej tq cilave vetqm 2'000'000 shpenzoheshin për atë vilajet.

Mbledhja e ushtarëve

Por e ardhura tjetër ishte edhe më e vlefshme. Shqipëria nxirrte pothuaj ushtarët më trima në Europë. Malësorët Shqiptarë të lartë, të fortë e të pafrikshëm, përbënin gardën e Sulltanit. Mirditasit dhe malësorët përgjithsisht viheshin në pjesët më me rëndësi të ushtrive turke. Shumë prej tyre morën lavdërime dhe pozita të larta si në ushtri ashtu edhe në administratë. Edhe në ditët e Romës pat qenë ideja për ta bërë Shqipërinë një fole për rritje dhe nxjerrje luftëtarësh, por Turqit e përmbushën këtë ide. Duhet shënuar se po të ishte Shqipëria e përparuar, e edukuar dhe e lumtur, nuk do t'i jepte ushtarë Turqisë. Për këtë arsye padituria, veçimi i saj nga bota e përparuar dhe varfëria u zgjodhën prej turqëve si vegla për të mbajtur nën thembër këtë popull trim.

Coptimi i vendit

Siç duket, ishte vendosur në çdo fuqi mendore zhvleftësimi moral, intelektual, shpirtëror, ekonomik dhe politik i këtij populli. Zyrtarët që të

gjithë ishin të pasjellshëm; të ashtëqujturat salla të drejtësisë, gjyqet, nuk mbronin as persona as pasuri. Njerëzit viheshin në burg me dëshmira të fshehta. Gjithë lëvizjet për bashkim prisheshin nga nëpunësit e pashpirt dhe gjithë masat për punë e industri pengoheshin nga tagrambledhësit. Mund të thuhet se këto janë kondita edhe në vende të tjera të nënurdhëruara, por jo kaq sistematikisht. Miniera ari patën qenë punuar prej Romakëve e argjendi prej venedikasve. Këto patën qenë mbyllur shumë kohë përpara me urdhër qeveritar dhe tani as vendi nuk u dihet. Pyje të mëdha shkonin më kot dhe kalbeshin për arsyeza ligjore dhe transportimi. Ndërsa në shtetet e tjera të Europës ka një endje të madhe hekurudhash, ky vend nuk ka asnjë rrugë hekuri prej Veriu në Jug. Fuqira të mëdha ujrash nuk përdoren; porte shumë të mirë janë pa mbrojtje dhe pa ndërtesa doganore. Lumenj, nëer të cilët duhej të lundronin avulllore me transportuar lëndët e pyjeve në tregjet botëore, janë të vdekur e të padobishëm. Përveç ç'ka lanë Romakët, rrugë të tjera nuk ka; një njeri për të shëtitur prej bregut në brendinë e vendit ose prej një qyteti në tjetrin, duhet të shkojë mbas gjurmave ose nëpër ndonjë rrugë qorre. Portet e sigurtë dhe hekurudhat do të ishin mjete për të bashkuar Shqipërinë me botën e jashtme dhe rrugët e gjëra do ta bënin të lehtë kalimin prej një qyteti në tjetrin. Por ndërlidhje të tilla do t'i kujtonin popullit dobinë e qytetërimit dhe do të bëheshin shkak kundërshtimesh dhe kryengritjesh. Parimi i mallkuar për të mbajtur këtë vend të veçuar, si

brenda me njëri-tjetrin ashtu dhe me botën e jashtme, ishte shkak që e la këtë vend të verbët e të errët, ndërsa nëpunësit e Turqisë mbushën botën e jashtme me propaganda mbi egërsinë e këtij populli dhe rreziqet e udhëtimit në këtë vend. Por historitë dhe shënimet nuk tregojnë për ndonjë të huaj që u gjend ndonjë herë në rrezik në tokën Shqiptare; doemos ata që nuk prunë me vehte ndonjë komplot ose tjetër qëllim të keq për popullin. Përgjithësisht çmohet mikpritja e Shqiptarëve prej atyre të huajve sa më tepër që ata e vizituan këtë vend me qëllim miqsor. Në këtë tokë me fjalën qytet quajmë një vend që nuk ka më shumë se 40'000 banorë.

Një tokë e begatë

Në Shqipëri ka fusha të mëdha dhe pjellore të cilat mund të ushqenin miliona, por tani ato vetëm gërricen me një parmendë druri e nuk punohen. Shumica e tyre janë të mbuluara me barishte të padobishme ku kullos bagëtia e dobët e vendit. Minierat janë të pagërmuara e të paditura. Ata më me dituri në mineralogji thonë se toka Shqiptare ka qymyr guri, vajguri, hekur, asfalt e bakër, por zbulimi dhe shfrytëzimi i tyre nuk është lejuar kurrë. Prodhimi i të lashtave, misrit, ullijve, pemëve e vreshtave, po të përpunoheshin do të ishte shumë i madh, ndërsa peshku nuk ka të sosur. I shkreti bujk, me që të shumtën e veglave si dhe kaun me nga tokën shpesh herë i merrte me qera nga se do të paguante medoemos e me çdo sakrificë taksat e rënda, edhe pse vetvetiu i varfër nga rrjedhat e

kohëve, ndalëngadalë la punimin e tokës që nën një punim të mirë mund të nxirrte miliona e u vu të ruajë ato pak bagëti që pati dhe toka pjellore u la pothuaj krejtësisht si vend kullotë. Por edhe bagëtia e tij është në një gjendje shumë të keqe; leshi nga ashpërsia e tij ka një vlerë shumë të pakët dhe raca e bagëtisë se tij nuk është përtërirë kurrë. Sasia e madhe e lëkurëve shkon më kot për pamundësinë e transportit dhe për padijen e përgatitjes së tyre. Pa shikoni! Sa keq! Në mes të Europës një tokë e pasur, një tokë pjellore të ndodhet në këtë gjendje si me qenë në mes të një shkretëtire!

Parimi i zhvleftësimit

Shqipëria ka plot gojëdhana të së kaluarës por turqit nuk lejonin gjermime, gjë që mund t'i sillte ndërmend këtij populli lulëzimin e parë. Mësimi i gjuhës Shqipe ishte krejt i ndaluar në çfardo shkollë. Sot nuk ka ndonjë alfabet të caktuar, s'ka shtypshkronja që të shtypin gazeta dhe libra për këtë popull. Rregullat turke arrestonin dhe internonin ata të cilëve u gjenin qoftë edhe në postë libra të çdo lloji në gjuhën Shqipe. Gjuha e Shqiptarve duhej të heshte për hir të sunduesit. Që mos me u dhënë raste për bashkim për të kërkuar lirinë dhe të drejtat e tyre, turqit ndiznin dhe shtonin çdo ditë e më tepër armiqësinë në mes familjeve, lagjeve, katundeve dhe besimeve të ndryshme. Fanatizma dhe shpërblimet që merrnin kryetarët e vendit kanë qenë helmi më i fortë për të mëkëmbë çdo të keqe dhe kanë rënduar zgjedhën e

kanë penguar përparimin. Djali katundar i lindur në Shqipëri u rrit krejt i paditur për arsye se Turqia lejoi të hapen shumë pak shkolla në gjuhën e saj, përveç atyre të huaja; kështu që mos të zgjohej mendja, shpresa dhe ambicja e të riut Shqiptar. Babai i shkretë, i mbytur në varfërinë e tij, mund t'i jepte djalit të vet vetëm një rrugë jashtë shtetit duke e dërguar në Stamboll ku medoemos do t'i përshtatej jetës ushtarake, do të gufosesh nën një uniformë me xhufka dhe do të ushqehesh nga kazani i mbretit. Megjithatë kurrë nuk e pa të arsyeshme sundimtari turk zgjimin e djalit Shqiptar.

Europa përkrah sundimin turk

Diplomacia e Europës e ka njohur gjithmonë karakterin e keq të sundimit turk. Për turp të kësaj diplomacie i është thënë kjo e vërtetë në shesh, por gjithë këtyre protestave fuqitë e mëdha i janë përgjegjur: “Shqiptarët janë një racë e egër”. Asnjë njeri në Europë nuk e njohu më mirë popullin dhe tokën Shqiptare sesa italianin i famshëm, Markezi San Xhuliano. Me një penë të fortë ky zotni e ka hartuar kulmin e mizorisë me të cilën sundimi turk poshtëroi dhe shkretoi një popull, për trimërinë dhe kapacitetin e të cilit ky shkrimtar ka një respekt. Por, sikurse e thotë edhe vete, nga pozita diplomatike që kishiu desh me i mohuar të drejtat e Shqiptarëve me këto fjalë: “Prandaj Italia interesohet me e lënë të paprekur nderin e Sulltanit në Shqipëri nga çdo pikpamje; përkundrazi, me sa

të jetë e mundur do ta mëkëmbë edhe më dhe do të ndalojë çdo gjë që mund të shkaktojë zhdukjen e sundimit të tij ose që mund të shkaktojë kondita të cilat, herët a vonë, mund të bëhen shkak për ndërhyrje të huaj ose për shqetësim të përgjithshëm”. Me këtë shpirt i dënoi Europa shqiptarët me robërinë e ndyrë dhe veçimin e tyre nga bota e jashtme, me shtypjen e pasurisë dhe të industrisë së tyre, me paditurinë që e mëkëmbi çdo ditë, me fanatizmin që futi në mes tyre, me varfërinë dhe me shtypjen e ndjenjave të tyre.

Mundime për liri

Nuk do ta përshkruaj historinë e gjatë se si Shqiptarët me lidhjet, kongreset dhe kryengritjet në çdo formë janë munduar me zhdukur robërinë e tyre. Mjafton që Turqia gjatë shekujve e njohu pazotësinë e saj dhe pamundësinë për të shkelur Malësorët. Asnjë këmbë ushtari turk nuk guxoi të hyjë në brendinë e maleve. Biles, një herë kur Sulltani desh të mësynte Malin e Zi, më parë mori leje nga malësorët e pastaj mundi të kalojë ushtria e tij. Asnjë herë nuk doli fituese Europa në planet e saja që me anë traktatesh e lidhjesh është munduar ta fshije emrin e këtij populli nga radha e popujve. Shqipëria nuk e njohu traktatin e Berlinit dhe tani po kundërshton edhe marrëveshjen e Londrës. Pikërisht në këtë kohë që po e shkruaj këtë libër, Italia ka zënë qytetet e bregut Durrësin e Vlorën, për të vetmen arsye që të gjejë popullin me armë në dorë dhe i cili patjeter do ta kundërshtojë

shkeljen e tyre. Mbetet për të parë në qofte se imperializmi, militarizmi dhe detaria, gjëra që e kanë prurë Europën në dhëmbin e vdekjes, do ta ruajnë këtë apo jo nga dënimi për mëkatet që ka bërë. Në qoftë se gjykimi i drejtë i njerëzisë do të sjelli një jetë të re të përgjithshme, paqe e vllazërime, duhet të hedhë poshtë e të zhdukë edhe diplomacinë e fshehtë që ka qenë dhuna dhe urrejtja e përgjithshme që ka sjellë gjithë mizoritë e sotme. Është kjo lloj diplomacie që e mbajti Shqipërinë me shekuj nën sundimin e ndyrë të Turqisë, e mbyti në varfëri, i mbylli dritën e qytetërimin dhe në gjithë rrugët që të çonin për në këtë vend vunë shenjën: “Është e rrezikshme - rrini larg”. Më në fund, kur qe thyer zgjedha turke vetë Europa iu vu punës në këtë vend duke qethur nga kjo tokë pjesët gati më me rëndësi dhe mbi copën që mbeti mori përsipër me krijuar një qeveri aq despotike në karakterin e saj sa që as qeveria e Stambollit nuk e kish paraparë kurrë. Në vend që me iu dhanë ndonjë farë sigurimi për liri e një statut Shqiptarëve, Europa pruri një princ, një komision ndërkombëtar dhe një organizatë të huaj xhandarmërie për të sunduar Shqipërinë, si duket pa e menduar aspak që edhe ky popull duhet të ketë një zë në qeverinë e tij. Kjo qe haptazi një tirani absolute.

Një komb atdhetdashës

Malsorët trima u pergjigjën menjëherë. Pikërisht si zëri që ushtoi nëpër shpatet e maleve të Zvicrës në

veshët e Hapsburgëve, edhe zhurma e burisë së tyre mbërriti deri në muret e sallave të Uestminsterit të Londrës. Populli trim i Shqipërisë nuk u tmerrua nga fuqia Europiane. Ata që kishin luftuar një tirani do të luftonin edhe një tjetër. Ata kishin vënë para fjalën DREJTESI dhe për çdo marrëveshje që thirreshin me bërë, përgjigjeshin: “Dëboni një herë princin tuaj”. Prej Epiri e deri në thellësinë e maleve të Veriut u zgjua një kundërshtim ndaj princit. Nga kjo gjë agjentët e Europës dridheshin në portin e Durrësit dhe më në fund e lanë tokën Shqiptare. Këto atdhetare nuk priheshin nga diplomatë dinakë ose të tërhiqeshin nga hunda prej ministrash a parlamentarësh. Ata ishin vetëm njerëz të lirë që luftonin për lirinë e tyre dhe të cilët duhet të priten nga Amerikanët në tempullin e patriotëve.

Amerika nuk e din

Por Amerika rri në heshtje. A nuk ka vapore me kryqzuar detërat për të shpëtuar barinj të, emigrantët e Vlorës? Asnjë shtet nuk u mundua me iu ardhur në ndihmë në vuajtjet e rënda këtyre viktimave të diplomacisë së padrejtë të Europës. Populli i Shteteve të Bashkuara nuk e di faktin që unë po i shkruaj këto fletë vetëm për t’i parashtruar këtyre ndodhinë e dhimshme të Shqiptarëve trima, të cilët lypin lirinë e tyre, të fëmijve dhe të nipërve të tyre. Mundet që unë jam gabim duke vënë mëshirën dhe bamirësinë më në fund, mirëpo tirania ka luajtur një rol të tmerrshëm mbi këtë popull, edhe pse pak mijra njerëz duke lutur

hyjnitë nëpër shpatet e maleve të tyre nuk numërojnë mjaft. Ajo që numëron më teper është nëse duhet të ketë apo jo ky popull lirinë dhe shpëtimin e vet të brezave të ardhshëm.

Çfar mund të bëjnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Anton Arnu, një gazetar i shquar frëng, më 19 Dhjetor të vitit të kaluar tha për Shqipërinë: “Me një popullsi më pak se një milion dhe me një sipërfaqe afro 34299 km katror, Shqipëria është një vend i pazhvilluar dhe populli i pafat i saj është duke vdekur. Kjo rrjedh drejtpërsëdrejti nga sundimi i keq dhe i padrejtë gjatë shekujve. Praktikisht s’ka rrugë e ura e asnjë udhë hekuri, s’ka të holla ose kredit dhe është e rrethuar nga të gjitha anët prej luftash përveç ballit të Greqisë, por edhe këndeje është viktimë e intrigave. Përsëri ata meritojnë të jenë më mirë. Ata nuk vodhën Pjetrin për të paguar Palin; ata nuk kanë qenë fallco në punën e tyre. Shqiptarët janë një popull i mirë por mjerisht pa agentë shtypi”. “Pa agjenta shtypi!” E vërtetë! Si popull i panjohur ka nevojë për agjentë shtypi që historia e Shqiptarëve t’i bëhet e ditur popullit Amerikan, t’i bëhet e ditur edhe se Shqiptarët janë burra dhe gra simpatike, mëshironjës e liridashës, në mënyrë që Amerika t’i japi dorën këtij populli për ta ngritur nga mjerimi në një jetë të rë e të lirë. Bajroni e vizitoi këtë tokë por kaloi për të ndihmuar lirinë greke, ndërsa Gladstone qe mbrojtës i Malit Zi. Emrat e tyre janë

të çmuar në jetëshkrimin e shteteve që ata përkrahën. Gjithashtu edhe disa njerëz besnikë Amerikanë mund të punojnë për lirinë e Shqipërisë.

Bamirësi apo drejtësi

E kuptoj se mendimi më i parë dhe e para gjë që populli i jonë do të thotë është se “Amerika nuk duhet të zhysi duart në punët e përgjakshme të Europës”. Por në anën tjetër, çdo rast për bamirësi prej nesh është i mirëpritur. Miliona dollarë po kalojnë oqeanin për t’u ardhë në ndihmë viktimave të luftës që vuajnë në Belgjikë, në Rusi, në Serbi dhe në Francë. Sigurisht, mëshira për të shpëtuar edhe popullin e përvujtur Shqiptar do të tërheqi patjetër zemrën e popullit Amerikan. Por nuk është punë e mirë me mëkëmbur këtë popull vetëm për të ngjallë viktima të reja për në frontin e tiranisë, padrejtësisë dhe të varfërisë. Mbi këtë popull ndihma për ta nxjerrë nga varfëria dhe ndihma për t’i siguruar lirinë duhet të shkojnë doradorës. Që Shqipëria është përdorur shumë keq prej Europës s’ka dyshim. Për t’u dhënë fund gjithë padrejtësive mund të përdoret vetëm e drejta. Edhe tani Shqiptarët janë me armë në dorë kundër Italisë e Greqisë që ua kanë pushtuar tokën; dhënia fund e kësaj do të sjellë paqen. Lufta Europiane e ka lënë Shqipërinë pa qeveri e të humbur në mes të shteteve të tjerë. Të formuarit e një vetqeverimi është një premtim për pavarësi të plotë.

Shqipëria e pavarur

Në qoftë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës i japin dorën parisë Shqiptare duke i mbledhur së bashku për të zgjedhur nëpunsat e vendit dhe për të vënë përpara një statut, ata do të bëjnë atë që Europa nuk mundi ta bëjë, gjë të cilën medoemos do ta shohë të arësyeshme. Europa nuk duhet të tregohet e pakënaqur për një qeveri që i pelqen popullit vetë. Gjashtë fuqitë Europiane krijuan shtetin e lirë të Shqipërisë, por duke mos qenë të zotët me themeluar një qeveri e lanë këtë vend në dorë të fatit. Megjithëse marrëveshja e Londrës u prish nga lufta, pavarësia Shqiptare nuk mbeti e pa bërë. Nuk ka fuqi tjetër në faqen e tokës që të kërkojë të drejtë mbi këtë vend tani veç popullit Shqiptar. Italia dhe Greqia që kanë shtyrë ushtritë e veta në Shqipëri thonë se e bënë këtë vetëm për të mbrojtur pasurinë dhe jetën e vendasve. Populli i Shteteve të Bashkuara mundet ta ndihmojë këtë popull duke iu siguruar paqen dhe duke larguar anarkinë. Mundet që t'i udhëheqi Shqiptarët me formuar një qeveri të përkohshme edhe deri sa këta të vihen në udhën e drejtë të punës e të përparojnë në vetqeverimin e tyre. Nuk e mohoj faktin se gjithë këto që thashë mund të mos realizohen plotësisht, por çdo hap në nxjerrjen e lirisë së tyre, e sa do i vogël qoftë, nuk është kurrë i kotë. Mundime të tilla doemos do të shoqërohen me përfundime të zyrtarve të lartë të qeverive Europiane. Sër Eduard Grei mund t'i përsërisi fjalët e bukura të Gladstonit dhe të gjithë njerzit nën armë duhet të presin më gëzim një qeveri të rregullt. Në qoftë se me gjithë ndihmat e

dhëna bashkimi Shqiptar nuk bëhet, atëhere faji bie mbi Shqiptarët vetë. Ata nuk mund të shpresojnë kurrë më për kushte më të favorshme se këto të sotmet për të fituar lirinë dhe vetqeverimin e tyre.

Fati i Shqipërisë

Asnjëri nuk mundet të thotë se Shqiptarët nuk janë të zotët për vetqeverim, sepse asnjë rast prove nuk u qe dhënë për të formuar një qeveri të vetën. Markezi San Xhuliano ka patur të drejtë që ka thanë: “Shqiptarët janë një fuqi e paprovuar për sa i përket vetqeverimit, as prej vehtes e as prej të tjerëve”. Në zakone, në udhëheqje, në karakter ose në mundësi u ngjajne shumë Skocezëve të hershëm; janë pikërisht si ata të papërkulur dhe liridashës, gjëra që karakterizojnë edhe malësorët e Svicrës. Koha më e volitshme që pritet për vendimin e fatit të Shqipërisë do të vijë kur të bëhen traktatet e paqes Europiane. Kur të vijë kjo ditë, pa lejuar ndërhyrje intrigash e shpirtkeqsije, Shtetet e Bashkuara do të qëndrojnë si avokate të një populli të vogël e pa fuqi që me plot të drejtë e arësye kërkon lirinë e vet. Duhet shënuar se Austria, Italia, Mali i Zi, Serbia dhe Greqia, që të gjitha dëshirojnë me e patur Sliqipërinë; është edhe aq e drejtë se asnjëri prej tyre nuk dëshiron që tjetri të dalë fitues. Në këtë gjendje të punëve është shpresa më e madhe e Shqiptarve. Ata janë një popull i veçantë, flasin gjuhën e tyre dhe kanë kufi krejt të shquar nga tjerët si në zakone ashtu edhe nga

natyra e tokës. Është larg mendjes që Europa të mundi të ushtrojë paqen duke humbur të drejtat e këtij kombi ose duke e ndarë tokën e tyre. Ngjarjet e kohës së Vidit e pasqyrojnë faktin që pa u siguruar liria e plotë e Shqiptarëve është i pamundur ndalimi i luftës dhe parimi për të ndarë tokën Shqiptare do të hapi një plagë të re e të helmatisur në politikën e Ballkanit. Dardanelet do të hapin një problem mjaft të rëndë, zhvillimi i të cilit është i tepërt për fuqitë e mëdha, e për këtë nuk është nevoja ta ngarkojnë vehten edhe me një problem tjetër si ky i Shqiptarëve.

Të drejtat e një kombi

Me sa duket, Gjermania dhe Austria nuk e mendojnë më zgjerimin e fuqive të tyre në Shqipëri. Dhe as nuk besohet të kenë ndonjë kundërshtim mbi deklaratat e Sër Eduard Greit që thotë: “Gjithë kombet e Europës të jenë të lirë të formojnë sipas dëshirës vetqeverimin e tyre e t’i prinë vetë përparimit të vet në liri të plotë; ky ideal i jonë përfshin pa përjashtim gjithë kombet e Europës, të vegjël e të mëdhenj”. Kjo deklaratë mëshiron të vërtetën dhe të vetmin parim mbi të cilin mund të bazohet një paqë pak a shumë e gjatë. Kjo përjashton çdo marrëveshje e çdo mendim për të hequr Shqipërinë nga radha e shteteve. Meqenëse fuqitë e mëdha janë detyruar me dhënë pavarësinë Shqiptare si shtet, deklaratat e Sër Eduard Greit janë një garanci për vetqeverimin e tyre. Pra, vetëm një konditë mbetet për t’u mbushur nga Shqiptarët

vetë, dhe kjo konditë është nënshkrimi në mes tyre dhe organizimi kombëtar. Në qoftë se Shqipëria është e zonja me dalë para Konferencës së Paqes me prova të sakta se ka zotësi të vetqeveriset, lutjet e saja për liri dhe për të mbledhur gjithë tokat që i përkasin në bazë të së drejtës do të jenë të pranueshme dhe pa vonesë.

Opinionimi popullor i Shteteve të Bashkuara mund t'i kujtojë mundimet e veta për liri dhe mund të bashkohet me ta. Prandaj dera e lirisë është e hapur për Shqiptarët. Unë kisha me thënë se ata e kuptojnë rastin, por meqenëse janë të këputur e të varfër kanë nevojë për ndihmë që ta realizojnë krejtësisht faktin. Sigurisht Amerika nuk mund të gjejë rast më të nderuar bamirësie se sa me ndihmuar dhe me udhëhequr Shqiptarët për të siguruar një paqe kombëtare dhe një rregull të mbrendshëm. Një rast i tillë nuk ka shembull në historinë moderne. Organizatat e paqes mund të shpenzojnë miliona në bamirsira, por kurrë nuk kishin me bërë punën që bëjnë pak mijra duke i përdorur për të ndihmuar këtë popull të varfër, të munduar, të vuajtur e të shpërdoruar, për të formuar një qeveri dhe si komb i organizuar të dali para Konferencës së Paqes e të kërkojë autonominë e vet dhe "vendin e vogël nën rrezet e Diellit". Është shpresë e madhe se prej këtij konflikti kontinental do të lindi një vllazëri e re në mes të kombeve dhe meqenëse Shqipëria nuk ka autoritet të brendshëm për shkak të atyre që ndezin cmira apo zemërime në konflikte, ajo do të jetë i vetmi shtet që do të

kërkojë më tepër vetminë dhe qetësinë pa u perzjerë në ngatërresat e të tjerëve.

Paqja e Europës

Simbas opinionit tonë, paqja e Europës do të jetë një zbutje e përgjithshme. Në të tilla raste paraqitja e Shqipërisë si komb i vetqeverisur patjetër do të sigurojë lirinë e saj. Sikurse çdo shtet tjetër i Ballkanit, as Shqipëria nuk mund të coptohet e t'u ndahet shteteve fqinjë. Europa që do të bëjë paqen dhe ka krijuar shtetin e pavarur të Shqipërisë nuk mund ta mohojë dhënien e lirisë së plotë në qoftë se Shqipëria e organizuar u del përpara dhe ngul këmbë në të drejtat e veta. Një shtet i formuar në këtë mënyrë nuk do të ishte një kanosje për paqen e Ballkanit; nuk do të mund të kishte flotë që të alarmojë Italinë ose Austrinë në Adriatik. Ngritja e hekurudhave dhe përmirësimi i porteve të saj do të lejonin miqësisht dhe me anë traktatesh tregtare edhe daljen e Serbisë në Mesdhe se sa me shkelje e barbarizma. Shqipëria e pavarur nën zhvillimin e saj ekonomik do të niste një jetë të re duke kthyer shpatat në plugje, rrugët e verbëta në rrugë të gjëra, katundet në qytete të vegjël dhe qytetet e vegjël në qytete me rëndësi. Shqiptarët, përveç të drejtës, mund të kërkojnë edhe ndihmë nga Europa, sepse mbi Europën e krishterë bie përgjegjësia dhe shkakun që ky popull qe bërë skllav e qe varfëruar. E kam thënë që Europa e krishterë në kundërshtim me protestën time shkaktoi që të emigrojnë në qarkun e Vlorës 100'000 katundarë,

të cilët tani po zhduken nga uria dhe as vend ku me shtirë kryet nuk kanë; e vetmja çati e tyre është qielli.

Detyra e krishterë

Ndaj Shqiptarëve, krishtërizmi European dhe mohamedanizmi shkaktojnë si njëri ashtu dhe tjetri varfërinë dhe robërinë. Krishtërimi që në Shtetet e Bashkuara jep liri të plotë, vetqeverim, lumturi e mbi të gjitha dashurinë, do të japi një shembull vllazërimi dhe bashkimi në mes të Shqiptarëve. Kundër gjithë shpifjeve që i janë ngarkuar këtij populli me fjalën e ngurtë “barbar”, unë vej këto fjalë të zotit Erikson, i misionit Amerikan, i cili është dhënë mbas Shqiptarëve, ka punuar dhe ka vuajtur me ta: “Nuk ka popull më shpirtmirë e më të sjellshëm në Europe sesa Shqiptarët. Ata si elementë fuqie, burrnje dhe kuraje mblidhen me më të madhen besnikëri dhe japin jetën për fjalën e dhënë”. Shqiptarët njohin Mohamedin dhe Krishtin si profetë, por më kot u luten si për njërin ashtu edhe për tjetrin. Në emër të kujt t’i bëjnë tanimë lutjet për lirinë e tyre? Unë kam një besim të qëndrueshëm se kur shtetet kundërshtonjës të lirisë Shqiptare do të jenë duke heqë frymën e fundit, të përgjakur e të shkatëruar dhe grindjet e konfliktet të kenë marrë fund, vetëm atëhere do të arrijnë në veshët e tyre thirrjet dhe lutjet e Shqiptarëve për lirinë e vet. Shpresat Europiane tani përqëndrohen për një paqe duke u bazuar më shumë mbi drejtesi se mbi forcë në një vllazërim

dhe bashkëpunim të përgjithshëm. Një paqe e tillë do të dijë dhe do të pranojë se çdo racë e çdo besim ka të drejtë me ekzistuar dhe se kufijtë e kombeve do të vendosen si është e drejta dhe ku gjejnë më pak kundërshtime.

Detyra e Amerikës

Unë kam në ndërgjegjen time të drejtat dhe lutjet e këtij populli sepse më ra mua shorti të flas e të them për ta të vetmen fjalë shprese, prej një burimi politik, e cila duhet të ishte thënë shekuj më parë. Për këtë arsye dhe më tepër pse unë jam Amerikan, shumica e kryesisë Shqiptarë më shikojnë me një farë mirëbesimi. Edhe tani e ushqejnë shpresën se unë do t'u jap zemër dhe bashkëpunim në mundimet e tyre për liri. Unë vetëm mund të bëj shumë pak për ta, por kam besim të plotë se shtypi Amerikan do të vejë gjithë fuqinë e tij për të ndihmuar formimin e vetqeverimit Shqiptar. Është një qëllim i shenjtë ky, e prandaj Amerika do ta bëjë medoemos.

Rasti i Amerikës

Pres këshilla dhe ndihma prej të gjithë miqve liridashës. Sigurimi i pavarësisë Shqiptare mund të jetë edhe një shërbim i madh për bashkimin Ballkanik dhe për paqen Europiane. Ndhma e Shteteve të Bashkuara mundet, ose patjetër që shkakton lulëzimin e kësaj shkretie të bërë nga duar njerëzish, edhe të japi fruta shumë të mira.

Kur parmenda e drujtë të zhduket dhe vendin e saj ta zejë plugu i çeliktë, atëhere toka pjellore e Shqipërisë mund të kthehet nga kullotë e padobishme në ara gruri e drithi, pyjet do të nxjerrin miliona nën një përdorim të mirë, fuqitë e ujrave mund të shfrytëzohen, shtretërit e miniereve mund të hapen, kënetat të thahen e të mbillen, pemishte të mëdha të krijohen, fara të përmirësohet dhe e gjithë bujqësia dhe industria e vendit me metoda shumë të lehta mund të shtohet. Princi Odeskalki i Austrisë thotë se delet e Astrakanit mund të zëvendësojnë racën e mjeruar të deleve Shqiptare dhe t'i sigurojnë katundarit një të ardhur të mirë. Me një qeveri të mirë, portet dhe lumenjt do të thellohen e do të përmirësohen, do të bëhen rrugë dhe hekurudha, do të bëhen të holla të vendit e do të krijohet kredidhënia dhe shërbimet e postave do të bëhen të qëndrueshme. Pjesët e mëdha të tokave qeveritare do t'u ndahen me vëmendje bujqëve, të cilat nën një administrim të mirë do t'i sigurojnë qeverisë një të ardhur të madhe. Do të ngrihen edhe shkolla dhe do të përgatiten mësues që të zhvillojnë mendjen e të rinjve. Kam folur me mësues në Vlorë të cilët kanë treguar shumë të madhe zgjuarsinë e djalit Shqiptar. Në pak vjet kjo lloj pune do t'i ndërrojë kushtet e këqia të sotme. Arkeologët e rinj do ta lartësojnë mburrjen e Shqiptarëve për heroizmin e të parëve të tyre dhe do t'i japin shkencës jo më pak se ata të Shlimanit (1822-1890); biles kjo pasuri e pafund në lashtësi është akoma e virgjër.

Shpëtimi i një kombi

Shumë Shqiptarë të Amerikës më premtojnë se janë gati me u kthyer në Atdheun e tyre posa të jepet një farë lirie në Shqipëri. Këta, të bashkuar me disa Amerikanë të vërtetë, do të rikrijonin një tokë të begatë dhe në vendin e tiranisë e të mizorisë së ndryshkur prej shekujsh do të mbillnin farën e lirisë. Doja të thoja se nuk ka rast më të mirë me bërë mirësi në asnjë vend të botës se sa në Shqipëri. Jo, nuk ka rast ma të mirë bamirësie se me vu në vijë vetqeverimin Shqiptar dhe me hap dyert e qytetërimin mbi ta, të cilat magjia e politikë Europiane i ka mbajtur mbyllur. “Jo bamirësi, por drejtësi” është thirrja e Shqiptarëve. Po si? Këto thirrje të bien në vesh të shurdhët?

Shpirtërimet për liri

E dij se ka burra e gra që do të ndjenin një kënaqësi të madhe duke shikuar këtë popull të mjeruar të kthehet në lirinë e bekuar të të parëve të vet, të cilën natyra e ka përgatitur për ta por njerëz shpirtligj e kanë penguar. Ka burra në Shtetet e Bashkuara që janë gati me i pre rrënjët e tiranisë kudo që të duken; në Shqipëri, a nuk janë këto fare në shesh? Ka shumë gra që me pasuritë e tyre të mëdha kërkojnë të bëjnë bamirësira për shpirtin e tyre. Sa gëzim të madh do të ndjenin këto duke parë një popull që do ngrihej nga fundi i tiranisë drejt lirisë së tij! Ato pastaj do ta kuptojnë vetë bamirsinë e tyre në jeten e rë të një populli të

përvujtur dhe sigurisht do të radhiten në fletët e lirisë së këtij kombi. Përmbi retë e zeza të imperializmit dhe të militarizmit European, rrezet e shkëlqyera të demokracisë Amerikane duhet t'i ndriçojnë rrugën njerëzve për një jetë më të mirë dhe për idealin pa fund: "Paqë mbi tokë, vullnet të mirë njerëzve". Këto mund të shkëlqejnë tani mbi Shqipërinë e përvujtur që po kërkon lumturinë e saj me anën e lirisë, se nuk është fajtores për ndonjë ofendim veçse për mbrojtjen e saj. Nuk ka mundim më të mirë se mundimi për të nxjerrë lirinë e një kombi. Me ndihmuar një njeri është një bamirësi; me liruar një popull nga zgjedha është një bamirësi e pavdekshme.

FUND

Marr nga www.pashtriku.org